



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:**

**“Software Engineering”**

**Universiteti “Metropolitan Tirana”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. As. Genci SHARKO**

**Dr. Frida GJERMENI**

**Shtator / 2024**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

1

**Tabela përmbledhëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Software Engineering”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Software Engineering”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr.344, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022 -2023 3 PAE / 2PAK Viti akademik 2023 -2024 7 PAE / 3PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023 5 studentë; Viti akademik 2023 - 2024 13 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Software Engineering” që zhvillohet dhe administrohet nga Universiteti Metropolitan Tirana, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT , Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin e objektivat e tij të sanksionuara në Statutin e UMT dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të tregut të punës. Ky program studimi është licënsuar nga MASR me Urdhërin Nr. 344, datë 17.09.2021 dhe ka filluar aktivitetin që prej vitit akademik 2022-2023. Programi zgjat 2 vite akademike, realizohen 120 kredite, gjuha e zhvillimit të programit të studimit: gjithë angleze.

Numri i studentëve të regjistruar në vitin e dytë të hapjes së tij, viti 2023-2024 është dyfishuar krahasuar me vitin e parë të hapjes, sikundër edhe cilësia e studentëve të regjistruar është rritur këtë vit. Zhvillimi i programit të studimit në gjuhë angleze synon tërheqjen e studentëve të huaj. Vijueshmëria do të tregojë nëse kjo do të jetë një ndërmarrje e sukseshme.

UMT bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e nivelit të mësimdhënies duke rekrutuar staf akademik me ekspertizë profesionale në përputhje me programin e studimit edhe pse punësimi i stafit të ri akademik efektiv me grada shkencore është një sfidë për të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë sot në Shqipëri. UMT ka garantuar për studentët e FSHKIT një infrastrukturë bashkëkohore (auditorë, laboratorë, biblioteka, zyra etj) dhe të mjaftueshme për të gjitha programet e studimit, që financohet kryesisht nga tarifat e shkollimit. Struktura akademike dhe ndihmës akademike mbështet studentët dhe stafin akademik në përparimin e tyre. Kjo strukturë përmes akteve të brendshme rregullatore, garanton barazi dhe transparencë të proceseve brenda UMT. Gjithashtu, studentët përfshihen në vendimmarrjen e UMT në të gjitha nivelet dhe sistematikisht iu merret mendim në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në UMT.

Nga UMT është në vëmendje mbështetja e studentëve edhe pas diplomimit, përmes rrjetit Alumni dhe bashkëpunimeve të shumta që ka me biznese e subjekte shtetërore e private të fushës së inxhinierisë elektrike dhe jo vetëm. Ky program studimi është i ri, ku ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve, ndaj treguesit analitikë për elementët e këtij programi nuk janë ende të matshëm, por fokusi në zhvillimin e software dhe TIK mbetet premtuese.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupit të vlerësimit të jashtëm me anëtarë ekspert: **Prof. As. Genci Sharko dhe Dr. Frida Gjermani** në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Software Engineering” vlerësoi dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar pranë ASCAL-it nga Universiteti Metropolitan Tirana. Anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të asistuar edhe nga Koordinatori Teknik i ASCAL Msc. Arbri Ndreka.

Vlerësimi i jashtëm u krye duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet e udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, hartuar nga ASCAL. Ekspertiza e vlerësimit të jashtëm është kryer në kuadër të akreditimit të programeve të studimit që Universiteti Metropolitan Tirana ka kërkuar për programin e studimit Master i shkencave në “Software Engineering”. GVJ kreu vizitën pranë Universitetit Metropolitan Tirana duke ndjekur agjendën e dakortësuar paraprakisht në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Software Engineerig”, për thellimin e vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm. Procesi i vlerësimit të jashtëm u krye në plotësim të këtyre parimeve:

- Paanshmëria në gjykimin në dhënien e vlerësimeve, për ruajtjen e standardeve dhe promovimin e përmirësimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm në gjykimet e tyre janë mbështetur vetëm në faktet e dokumentuara që UMT ka ofruar, bazuar në standardet që ASCAL ka miratuar dhe duke qenë krejtësisht të hapur për diskutimin bashkërisht të çështjeve që mund të ngrenë debat.
- Transparencë në trajtimin e çështjeve të rëndësishme dhe përcaktuese që jo vetëm karakterizojnë institucionin, por edhe japin avantazhet e disavantazhet kundrejt IAL-ve të ngjashme, japin sugjerime të dobishme në ndihmesë të përparimit të qëndrueshëm të IAL-ve.
- Pavarësia dhe objektiviteti në marrjen e vendimeve bazuar në argumentim të thelluar të fakteve.

Përmes shqyrtimit të dosjes së akreditimit, është kryer vlerësimi i cilësisë akademike dhe i cilësisë së mësimdhënies, i përputhshmërisë me standardet e cilësisë që UMT ofron në këtë program studimi.

Universiteti "Metropolitan Tirana", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.07.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.69/2 Prot, datë 17.07.2024. Universiteti "Metropolitan Tirana", njofton në ASCAL më datë 23.07.2024, me anë të shkresës me Nr. 69/3 Prot, datë 25.07.2024 "Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin që nuk kanë komente me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Software Engineering”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit “Metropolitan Tirana”, GVJ konstaton se në pikën 1 të këtij Statuti thuhet se ky Institucion vepron në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i cili promovon zhvillimin e arsimit të lartë sipas interesave kombëtare dhe konsolidimin e vlerave akademike. Në nenin 3/pika 4 të Statutit të këtij Institucioni citohet: “<i>Veprimtaria e Universitetit zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë</i>”.</p> <p>Nga sa më sipër mund të arrijmë në përfundimin se Universiteti zhvillohet brenda hapësirës kombëtare duke synuar zhvillim sipas parimeve evropiane për arsimin e lartë dhe asesi nuk bie ndesh me interesat kombëtare e kulturore të Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit Metropolitan Tirana, në pikën 5 të tij citohet si më poshtë vijon: Misioni i Universitetit “Metropolitan Tirana”, përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë etj. në përputhje me kërkesat dhe nevojat e universitetit;</li><li>2. Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike e kërkimit shkencor që kryhet brenda dhe jashtë vendit;</li><li>3. Formimin e studiuesve të rinj në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë etj, nëpërmjet</li></ol>

	<p>programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik;</p> <p>4. Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushat e shkencave të aplikuarra dhe inxhinierisë, ekonomisë etj. duke ofruar mundësi të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjate gjithë jetës;</p> <p>5. Kontribuimin në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit;</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Software Engineering” është një program i ciklit të dytë, i cila ka karakter inxhinierik dhe aplikime të TIK. Nga sa më sipër GVJ konkludon se ky program studimi zhvillohet në zbatim të misionit të këtij Institucioni për ofrimin e programeve të studimit me karakter inxhinierik për fusha të ndryshme duke përfshirë këtu Teknologjinë e Informacionit dhe aplikime.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><i>RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se Strategjia për Zhvillim, Statuti dhe Rregullorja e Institucionit janë 3 dokumentë themelorë që përcaktojnë dhe rregullojnë veprimtarinë e Universitetit Metropolitan. Në të tre këto dokumenta citohet qartë se fokusi i këtij Institucioni është ofrimi i programeve për të treja ciklet e studimit, ku përpos fushës inxhinierike që përbën një nga shtyllat kryesore të karakterit të programeve, është ofrimi i programeve që sjellin inovacion. Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Software Engineering” është në përputhje të plotë me këtë strategji zhvillimi. Karakteri formues i këtij programi studimi shpjegohet edhe në rregulloren e këtij programi studimi ku theksohet karakteri novator i këtij programi për fushën e Inxhinierisë së software.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><i>02 - Strategjia e zhvillimit te UMT</i></p> <p><i>03 - Rregullore e brendshme umt</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në RVB, si edhe takimet me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi GVJ konkludon se ky program studimi i ciklit të dytë ka si qëllim të tij përgatitjen e specialistëve në fusha të zhvillimit, testimit të programeve/Software dhe aplikacioneve për zgjidhjen e problemeve në fusha dhe sektorë të ndryshëm. Ky program ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT-së. Ky program studimi zhvillohet në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKSTI 2017-2020, drafti 2022-2023), si edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2021-2023)</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software RVB Takim me stafin</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se ky program studimi është zhvilluar në përputhje me interesat kombëtare dhe kulturore, në zbatim të strategjisë së tij të zhvillimit, Statutit, Rregullores, të cilët janë edhe dokumentat themelore të rregullimit dhe zhvillimit të veprimtarisë akademike të Institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



**Kriteri 1.** Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Universiteti Metropolitan Tirana shënon si vit themelimi të tij 2010 dhe ka kaluar procesin e fundit të akreditimit institucional ku me vendim të Bordit të Akreditimit, Nr.5, datë 27.01.2023, ka marrë akreditim për 5 vite me vlefshmëri deri më 26.01.2028. Përsa i përket kapaciteteve infrastrukturore, referuar informacionit në tabelat përmbledhëse/Tabela 16, ku paraqiten në formë shifrore informacionet mbi hapësirën në dispozicion për këtë program studimi, hapësirat më të rëndësishme janë 6 salla leksionesh, 14 klasa seminaresh 3 salla multifunkionale për aktivitete promovuese, 2 laboratorë për lëndët, 2 laboratorë informatike dhe 1 sallë interneti, me një hapësirë faktike 8.7 m<sup>2</sup>/për studentë. Lidhur me burimet njerëzore akademike Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 44 staf akademik nga ku 25 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 19 janë staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1
Prof.Asoc	4	3
Dr/PhD	8	6
Msc	10	9
Bsc	1	-
<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>19</b>

Nga sa më super GVJ konkludon se në dispozicion të programit të studimit janë burimet e nevojshme infrastrukturore dhe akademike.

*Aneks Tabelat/ Tabela 16*

*Aneks Tabelat/Tabela 6.2*

**Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e

Programi i studimit i cikli të dytë Master i Shkencave në: "Software Engineering" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë

<p>programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT-se. Bazuar në rregulloren e programit të studimit, si edhe RVB, GVJ konstaton se fusha e përgjithshme për këtë program është Teknologjia e Informacionit dhe nën fushë është Shkenca Kompjuterike. Inxhinieria e zhvillimit të Software përfshihet nën Shkenca Kompjuterike. Në këtë kontekst mund të konkludojmë se kemi një vendosje korrekte të programit të studimit nën njësinë bazë e njësi kryesore sipas fushatës së përgjithshme e më tej specifike akademike e kërkimore.</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Takim me stafin</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe takimet e realizuara me stafin e angazhuar për këtë program studimi GVJ konstaton se fusha kërkimore e tyre përputhet me natyrën inxhinierike të aplikuar për këtë program studimi. Kjo i jep mundësi stafit të realizojë në mënyrë më profesionale programin e lëndëve dhe ta përmirësojë vit pas viti duke marrë feedback edhe nga studentët.</p> <p><i>Aneks Tabelat/Tabela 4</i></p> <p><i>10 - Të dhënat e përgjithshme të programit të studimit</i></p> <p><i>48 - CV të e stafit të angazhuar në mësimdhënie</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>N / A</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar vërejmë se janë realizuar leksione të hapura nga lektorë të angazhuar në programin e studimit, por jo vetëm të cilat shërbejnë për ti ofruar studentëve njohuri më të thelluara. Një leksion i hapur në funksion të këtij programi studimi është “Open Lecture about Cybersecurity”.</p>

	<p><i>GVJ rekomandon që të realizohen më tepër trajnime profesionale më kompanitë me të cilat institucioni ka bashkëpunim, për të ndihmuar studentët drejt kalimit në tregun e punës, pasi eksperiencia në kompanitë që veprojnë në Shqipëri është e madhe dhe e larmishme</i></p> <p><i>53 - Lista e leksioneve të hapura, workshopeve, trajnimeve etj</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave "Software Engineering" është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. <u>GVJ rekomandon</u> që të realizohen më tepër trajnime profesionale më kompanitë me të cilat institucioni ka bashkëpunim, për të ndihmuar studentët drejt kalimit në tregun e punës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar GVJ konkludon se marrëdhëniet institucionale janë të përcaktuara qartë brenda njësive kryesore e njësive bazë për të garantuar zhvillim të frytshëm të programit të studimit dhe bashkëpunim me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit. Përpos rregullores së institucionit, secila njësi ka rregulloren e saj, sikundër edhe për çdo program studimi ka një rregullore të posaçme. Për këtë program studimi, në rregulloren e programit të studimit janë të ndara funksionet e përgjegjësit të njësive, përgjegjësit të programit të studimit dhe këshilltarit akademik i cili përfshihet drejtpërdrejtë me studentët në lidhje me problematikat e vështirësitë që ata mund të hasin. Njësia bazë</p>

<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>asistohet nga sekretaria mësimore, zyra e cilësisë dhe kurrikulave dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, për një monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim sipas problematikave të gjetura për programet e studimit.</p> <p><i>03 - Rregullore e brendshme umt</i></p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar vërejmë se Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi Erasmus+ me Universitete të ndryshme evropiane ku personeli akademik e studentët mund të përfitojnë nëpërmjet thirrjeve të mobilitetit. Gjithashtu Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë kompanish e institucioneve për të arritur objektivat e procesit mësimor.</p> <p><i>35 - Marrëveshje në kuadër te Programit Erasmus+</i></p> <p><i>37 - Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ vlerëson se marrëveshjet Erasmus+ që Institucioni ka aktive vlejnë edhe për personelin akademik e studentët e këtij programi studimi, të cilët mund të përfitojnë nga thirrjet e mobilitetit për të krijuar eksperiencë në proceset akademike në Universitetet pritëse në Evropë. Edhe pse Institucioni ka aktive një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani/ institucione vendase të cilat shërbejnë edhe si kompani/institucione pritëse për zhvillimin e praktikave profesionale,</p> <p><i>GVJ vlerëson se për këtë program studimi të ri, është e nevojshme lidhja e marrëveshjeve të reja me kompani të tjera kryesisht të fushës së zhvillimit software dhe aplikacioneve në mënyrë që studentët të tranzitojnë më shpejt në tregun e punës.</i></p> <p><i>35 - Marrëveshje në kuadër te Programit Erasmus+</i></p>

	37 - Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i raportit vjetor të njësisë bazë për vitin akademik 2022-2023, pasqyrohen 2 projekte ndërkombëtare ku personeli akademik është përfshirë, konkretisht MADRS dhe SMART4ALL duke përfituar edhe lëvizje në universitetet partnere. Tregues të tjerë në lidhje me përfitime nga marrëveshjet e bashkëpunimit nuk ka sepse ky program studimi është ende i ri dhe historiku kohor i pasqyrimit të treguesve analitikë është i shkurtër.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitete ndërkombëtare evropiane si edhe aktorë vendas në kuadër të lëvizjes, kërkimit shkencor, realizimit të programit të studimit, por në lidhje me programin e studimit efektet analitike nuk janë ende të matshme sepse kemi të bëjmë më një program studimi ende të ri.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit,	Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave “Software Engineering” vlerësohet nga GVJ si i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite të ndara në leksione, ushtrime, laboratorë



<p>veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>dhe detyra në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 2 vite dhe në total 120 kredite. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e mbrojtjes së diplomës me temë.</p> <p><i>VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Master i Shkencave “Software Engineering”, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimin e shprehive të veçanta. Studimi i Tregut evidentoi disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi. Disa nga profesionet dhe specialitetet për të cilat formohen studentët e Master i Shkencave “Software Engineering”, janë: zhvillues të arkitekturës Software, inteligjenca artificiale, baza të dhënash etj</p> <p>Në program trajtohen lëndë si p.sh.: "Advanced Object Oriented Programming". "Advanced Database Systems", "Software Testing and Verification" duke i dhënë mundësi studentit të zhvillojë njohuritë teorike dhe kompetencat praktike te nevojshme për tregun e punës.</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave “Software Engineering” përcakton në mënyrë të detajuar se në semestrin e katërt studentët zhvillojnë praktikën mësimore. Kohëzgjatja është 3 muaj kalendarikë dhe ka 12 ECTS. Gjithashtu. ne semestrin e katërt studenti zhvillon punim e temës të diplomës. Universiteti “Metropolitan Tirana” ka hartuar rregulloren e diplomimit dhe udhëzuesin e shkrimit të diplomës. Në të përcaktohen aktivitetet në kuadër të diplomës si: përfshirja</p>

	<p>në takime, përgatitjen dhe monitorimin e procesit të hartimit dhe shkruarjes së diplomës nga pedagogu.</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	N / A
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	N / A
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të</p>	N / A



veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.					
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nuk ka programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi.				
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit është kodifikuar sipas VKM Nr. 310 te datës 11.05.2022. Kodi i programit të studimit është <b>72MS0613A</b> .				
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk është program i cili ofrohet nga dy ose më shumë institucione të arsimit të lartë.				
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave "Software Engineering", organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

				X
--	--	--	--	---

## Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																											
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Software Engineering” është licencuar me Urdhër të MASR nr.344, datë 17.09.2021. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT që është dhe njësia kryesore për këtë program studimi është organizuar në tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;</li> <li>3. Qendra Kërkimore Shkencore;</li> </ol> <p>Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 44 staf akademik nga ku 25 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 19 janë staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT</th> </tr> <tr> <th>0000PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>4</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>8</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>10</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Bsc</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>25</b></td> <td><b>19</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndërsa departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike për këtë vit akademik ka këto të dhëna:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi i stafit</th> <th>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT		0000PAE	PAK	Prof.Dr	2	1	Prof.Asoc	4	3	Dr/PhD	8	6	Msc	10	9	Bsc	1	-	<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>19</b>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike		
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT																											
	0000PAE	PAK																										
Prof.Dr	2	1																										
Prof.Asoc	4	3																										
Dr/PhD	8	6																										
Msc	10	9																										
Bsc	1	-																										
<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>19</b>																										
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike																											

	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof.Asoc	1	1
Dr/PhD	4	4
Msc	3	5
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>11</b>

*Aneksi tabela Nr. 22 - Staf i Akademik.*

*06 - Vendimi për Akreditimin e Institucioni.*

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

GVJ vlerëson se praktikat mësimore zhvillohen në afate dhe me partnerët që UMT ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga Departamenti. Procesi monitorohet nga përgjegjësi i programit të studimit. Departamenti i Inxhinierive Kompjuterike ka përcaktuar një akademik (laborant), i cili mbikëqyr mbarëvajtjen e punës dhe mirëmbajtjen e laboratorëve

*46 - Vendim mbi përcaktimin e përgjegjësive të programeve 23-24*

*44 - VSA përgj programesh dhe keshilltare akademike*

**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

GVJ vlerëson se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si përgjegjës për programin e studimit monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë mësimorë. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion përgjegjësi i departamentit së bashku me përgjegjësin e programit të studimit dhe keshilltarin akademik të studentit monitorojnë procesin mësimor dhe të dokumentacionit për programin e studimit.

*46 - Vendim mbi përcaktimin e përgjegjësive të programeve 23-24*

*44 - VSA përgj programesh dhe keshilltare akademike.*

**Konkluzione**

*Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike/Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë, në të zhvillon mësim staf pedagogësh i kualifikuar të cilët kanë eksperiencë akademike dhe profesionale me titujt*

	<i>shkencorë. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT plotëson për vitin akademik 2023-2024 kriteret ligjore ai ka gjithsej 44 staf akademik nga ku 25 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 19 janë staf akademik me kontratë (PAK).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren, programin mësimor, syllabuset, orarin, ngarkesën e stafit akademik, CV e personelit akademik etj. Dosja e plotë e çdo viti mbahet në departamentin përkatës.</p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p> <p><i>10 - Të dhenat e përgjithshme të programit të studimit.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, kreditet e ndara sipas veprimtarive formuese etj. Në syllabuset e lëndëve jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminare, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuentimi, ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset e lëndëve. Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 2 vite dhe në total 120 kredite organizuar ne 4 semestra, me kohë të plotë.</p> <p>A. Lëndë Bazë: 9 ECTS / 7.5 % (sipas VKM 5-10%);</p> <p>B. Lëndë Karakterizuese: 63 ECTS / 52.5 % (sipas VKM 50-60%);</p>

	<p>C. Lëndë Ndërdisciplinore: 18 ECTS / 15% (sipas VKM 12-20%);</p> <p>D. Lëndë Plotësuese (Praktika): 12 ECTS / 10% (sipas VKM 10%);</p> <p>E. Detyrime Përmbyllëse: 18 ECTS / 15 % (sipas VKM 10-15%).</p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit jepen në rregulloren mësimore. Kandidatët fitues përzgjidhen nga Komisioni <i>Ad-Hoc</i>, i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekanati. Transferimi i studentëve në programe studimi të njëjta ose të afërta, vendase ose të huaja dhe ekuivalentimi i studimeve rregullohen me dokumentin e Rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve.</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software.</i></p> <p><i>49 -Komisioni i vlerësimit të krediteve të fituar nga programe të tjera studimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi duke përfshirë informacione të detajuara për temat e leksioneve dhe ushtrimeve. Programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës, sipas modelit të paraqitur në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar. Në fillim të çdo semestri pedagogu i njeh studentët me programin lëndor dhe veprimtaritë e përfshira në të, me detyrimet dhe përgjegjësitë, me formatet e vlerësimit dhe provimin final.</p> <p><i>12 - Model Silabusi</i></p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti</p>	<p>GVJ konstaton se çdo fillim viti akademik përgjegjësi i programit të studimit vlerëson ndryshimet e nevojshme dhe ja përcjell arkivit planin mësimor të vitin akademik përkatës. Planet arkivohet gjithashtu edhe në departament. Planet mësimore arkivohen në dy gjuhë shqip dhe anglisht.</p>



akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.									
<b>Konkluzione</b>	<i>Syllabuset e lëndëve të programi i studimit Master i Shkencave në "Software Engineering" përmbajnë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Anëtarët e stafit të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike përgjegjës për syllabuset kujdesen për përditësimin e lëndëve përkatëse.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Software Engineering" është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktikë. GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, një element mjaft i rëndësishëm ky për t'u përballur me tregun e punës pas diplomimit të tyre apo thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme në fushën e teknologjisë së informacionit, organizimit të të dhënave si edhe aplikacione softweri-ke.  <i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit</i> <i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit në Master i Shkencave "Software

<p>mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Engineering” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, aftësimi profesional dhe kërkimit shkencor.</p> <p><u>Në vitin e I</u> zhvillohen kryesisht lëndët bazë si “Advanced Numerical Methods”, “Advanced Data Structure”, “Advanced Software Engineering” dhe pjesërisht karakterizueset;</p> <p><u>Në vitin II</u> zhvillohen lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore dhe përmbyllëse si “Informatics System Security”, “Engineering Project Management”. Kjo mundëson që baza teorike e lëndëve të formimit bazë të shërbejë në përvetësimin më të mirë të dijeve prej lëndëve me karakter profesional.</p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave në “Software Engineering” dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit. Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtime (seminar). Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike.</p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Njohuritë e marra gjatë studimeve në këtë program studimi i mundësojnë studentit transferimin ose/dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, si dhe punësimin e tij në përputhje me fushën e studimit në ente publike dhe private kombëtare dhe ndërkombëtare. Sasia e orëve në auditor është 1212 orë, për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte) është 540</p>



	<p>orë, orë totale për përgatitjen teorike 360 orët e leksione dhe për praktikën me diplomën 312 orë.</p> <p>Orët në auditor për përgatitjen praktike zënë rreth 46 % të orëve totale. GVJ gjykon që raporti i tyre është në përputhje me ciklin e dytë të studimeve.</p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme pasqyron në ciklet e leksioneve dhe seancave praktike të reja që lidhen me lëndët përkatëse.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi se në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. Literatura është në gjuhën Angleze dhe janë tekste mësimore të përdorura ndërkombëtarisht.</p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse, evidentohet se programi i studimit ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synohen në programin dhe niveli Master i Shkencave.</p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Software Engineering” u jep mundësi studentëve të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit, duke kombinuar teorinë me praktikën, siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e inxhinierive informatike sipas kërkesave të tregut të punës si në sektorin privat edhe në atë publik.</p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p> <p><i>50 - Studimi i Tregut të Punës</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Përmbajtja dhe Organizimi në module/lëndë në Programin i studimit Bachelor në “Software Engineering”, krijon mundësinë e formimit profesional të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë aplikative më të fundit të fushës së informatikës duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës.</i></p> <p><i>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi se në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Software Engineering” është në përshtatje me kërkesën e tregut për specialist të kësaj fushe veçanërisht në atë të informatikës. Bashkëpunimet me institucionet të ndryshme në fushën informatikës i japin mundësi institucionit të konsultohet në mënyrë të herëpashershme me përfaqësuesit e tregut të punës të fushës së informatikës për përmirësimin e programit për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohe kërkesave të tregut të punës. Në kuadër të shkëmbimeve Erasmus departamenti vlerëson programet e institucioneve partnere gjatë shkëmbimeve të realizuara.</p> <p><i>35 - Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për	<p>Universitetit “Metropolitan Tirana” inkurajon studentët në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit Mastër i Shkencave “Software Engineering”.</p> <p>Sipas RVB Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë kryejnë takime të vazhdueshme me studentët në lidhje me zhvillimin e programit</p>

përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	mësimor ku shkëmbehen mendime dhe opinione për organizmin, funksionimin si dhe përmirësimin e tij.  <i>33 - Modeli i pyetësorit për studentet</i> <i>71 - Model pyetesor per studentet e diplomuar</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	GVJ konstaton se Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, si pjesë e detyrave të përcaktuara në rregulloren e saj ka mbajtur e kontakteve me alumnet e institucionit, si shembuj pozitiv suksesi dhe model orientimi. Sipas RVB diskutimet dhe propozimet nga studentët ALUMNI për përmirësimin e programeve të studimit janë të vazhdueshme.  <i>40 - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT</i> <i>51 - Aktivitetet e Zyrës ALUMNI</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe anëtarët e stafit të programit të studimit nxisin përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.6

#### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në	Objektivat formues të programit të Master i Shkencave “Software Engineering” përcaktojnë qartë objektivat e studimit dhe të kërkimit shkencor. Këto objektiva janë në përputhje me Strategjinë e Kërkimit Shkencor dhe prioritetet akademike të Universitetit “Metropolitan Tirana”. Pjesë e objektivit formues të programit të studimit është që t’u japë mundësi studentëve që

<p>përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>diplomohen në programin e studimit që në të ardhmen të punësohen si: programues të avancuar, analizues të të dhënave, programues të aplikacione mobile.</p> <p>Ndër objektivat formues për kërkimin shkencor është gjithashtu thellimi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij duke ju mundësuar atyre edhe ndjekjen e një karriere akademike nëpërmjet vazhimit të studimeve të ciklit të tretë (doktorata) në Inteligjencë Artificiale dhe Sistemet Inteligjente të afruar nga UMT.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><i>02 - Strategjia e zhvillimit te UMT</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore FSHKIT dhe njësia bazë Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike mbështetin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies të stafit dhe veprimtarinë kërkimore të stafit mësimdhënës. GVJ konstaton, bazuar në dokumentet e dorëzuar nga GVB dhe vendosur në reference, se personeli akademik udhëzohet për përdorimin e GoToMeeting dhe Edu4school gjatë mësimdhënies, përdorimin e librave në bibliotekën online të institucionit. Liria akademike respektohet dhe inkurajohet të reflektohet në veprimtaritë shkencore në UMT, në auditorët dhe veprimtaritë mësimore.</p> <p><i>02 - Strategjia e zhvillimit te UMT.</i></p> <p><i>52 - VBA per miratimin e riorganizimit te aktivitetet shkencor.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ konstaton se në dokumentin mbi planifikimin e kërkimit shkencor, është e specifikuar se në projektet kërkimore në grup inkurajohet dhe angazhimi i studentëve të nivelit Master. Programi i studimit parashikon zhvillim e lëndës "Research Method" në semestrin e tretë të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron</p>	<p>GVJ konstaton se të ardhurat buxhetore në pesë vitet e fundit është si më poshtë. Në të zëri i mbështetjes financiare për kërkim shkencor është deri në 3,3%. Nga shifrat në raport financiar burimi i të ardhurave është kryesisht tarifa e shkollimit, ndërsa të ardhurat prej granteve për kërkim zënë deri 3,3% të të ardhurave totale. Në raportin vjetor 2021-2022 deklarohen shpenzimet që UMT bën për realizimin e objektivave të saj:</p>



<p>të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpenzimet për paga, sigurime shoqërore 62%;</li> <li>- shpenzime për qera, energji elektrike, ujë, shpenzime mirëmbajtjeje, shpenzime për materiale kancelarie, blerje librash etj. 29%;</li> <li>- shpenzimet për Qendrën Kërkimore dhe Qendrën e Inovacionit, për pajisje laboratorike dhe trajnime të stafit akademik 9%;</li> </ul> <p><i>GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit por mbështetja financiare për kërkimin shkencor mbetet relativisht e vogël nga institucioni dhe të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme. Balancat financiare mbahen në nivel institucioni por jo në nivelin e njësisë bazë kjo vështirëson vlerësimin e fondit të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>73 - Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese 2022.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se brenda Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike orientohet drejt bashkëpunimit midis njësive kryesore dhe brenda UMT ekziston një bashkëpunim i mirë në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit por mbështetja financiare për kërkimin shkencor mbetet relativisht e vogël nga institucioni dhe të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme. Balancat financiare mbahen në nivel institucioni por jo në nivelin e njësisë bazë kjo vështirëson vlerësimin e fondit të kërkimit shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi II.7**

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Universiteti “Metropolitan Tirana” mbështet projektet kërkimore dhe ka bërë një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme kërkimore për bashkëpunim në punë kërkimore shkencore duke i dhënë përparësi ndërkombëtarizimit të universitetit. UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 23 universitete partnere Evropiane.</p> <p><i>GVJ vlerëson se UMT duhet të shtojë përpjekjet për shtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadrin e bashkëpunimit evropian në vitet në vijim.</i></p> <p><i>35 - Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ku zhvillohet programi i studimit Master i Shkencave “Software Engineering” i përgjigjet kërkesave për projekte me karakter kërkimor shkencor. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projektëve në UMT në bashkëpunim me stafin akademik të FSHKIT ka aplikuar në projekte kryesisht në programet e Bashkimit Evropian (Erasmus + KA2, Horizon2020, COSME, COST Action, CET. etj).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët janë inkurajuar të marrin pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga UMT dhe nga IAL të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Ky program studimi është në përputhje me një nga gjashtë prioritetet e Bashkimit Evropian “Europe fit digital age” ai përgatit kuadro në fushën e teknologjisë dhe të zhvillimeve të aplikacioneve Software në përputhje me nevojat e tregut aktual të punës si dhe prioritetet kombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Software Engineering” përgatit profesionistë në fushën e teknologjisë së informacionit. Ky profesion nuk bën pjesë në profesionet e rregulluara.</p>

kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.									
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian ( <i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Programi i studimit Master i Shkencave “Software Engineering” nuk bën pjesë në profesionet e rregulluara.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Inxhinierisë kompjuterike nxit dhe mbështet projektet kërkimore dhe ka bërë një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme kërkimore për bashkëpunim në punë kërkimore shkencore duke i dhënë përparësi ndërkombëtarizimit të universitetit. GVJ vlerëson se UMT duhet të shtojë përpjekjet për shtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadrin e bashkëpunimit evropian.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion vërejmë se format e transmetimit të dijeve për këtë program studimi janë leksionet, seminarët, sipas rastit orë praktike. Praktika profesionale është e përfshirë në programin lëndor në semestrin e dytë të vitit të dytë me 12 kredite ECTS. Sipas specifikave të lëndëve të ndryshme në formën e kontrollit të dijeve përfshihen frekuentimi i vazhdueshëm, provim i ndërmjetëm, provimi final, detyrat e kursit/ esetë etj.</p> <p><i>Aneks Tabelat</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe intervistës së realizuar nga GVJ me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi vërejmë se ka një integrim të koncepteve teorike me pjesën praktike të aplikimit nga ana e studentëve në orët e laboratorit apo seminarëve. Duke respektuar specifikat e lëndëve, për zhvillimin e pjesës praktike përgjithësisht përdoren software open-source, të cilët mund të instalohen në një numër pa limit kompjuterash në laborator. Për lëndët me fokus në programim përdoren ambiente IDE. Leksionet përgjithësisht shpjegohen nëpërmjet slideve, të cilat mund të merren nga secili student online nëpërmjet sistemit Edu4Schools.</p> <p><i>Aneks Tabelat</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik përfiton në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet marrëveshjeve që Institucioni ka lidhur në kuadër të programit Erasmus+, për mobilitet të stafit. Duke vizituar institucione të arsimit të lartë, në trajnime, apo edhe eksperiencë mësimdhënieje rritet cilësia akademike e</p>

	<p>personelit. Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare në partneritet me Universitete evropiane siguron rritje kapacitetesh për burimet njerëzore akademike. Së fundmi leksionet e hapura, apo workshopet e realizuara e njohin stafin me metoda e koncepte të reja të kohës si p.sh. Inteligjenca Artificiale apo siguria kibernetike.</p> <p><i>35 - Marrëveshje në kuadër te Programit Erasmus+</i></p> <p><i>36 - Mobilitete Stafit dhe Studente FSHKIT</i></p> <p><i>53 - Lista e leksioneve të hapura, workshopeve, trajnimeve</i></p>																																																			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion vërejmë se personeli akademik i angazhuar për këtë program studimi zotëron minimalisht gradën doktor shkencash.</p> <table border="1" data-bbox="619 1037 1369 1787"> <thead> <tr> <th>Lënda /Moduli</th> <th>Pedagogu</th> <th>Titulli/grada</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Advanced Database</td> <td>Rexhep Rada</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Advanced Machine</td> <td>Arben Asllani</td> <td>Prof. Asoc.</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Advanced Java</td> <td>Igli Hakrama</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Numerical Method</td> <td>Ligor Nikolla</td> <td>Prof. Asoc.</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Software Testing</td> <td>Ed lira Mertiri</td> <td>Prof. Asoc.</td> </tr> <tr> <td>6.</td> <td>Mobile</td> <td>Elton</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>Advanced Software</td> <td>Igli Hakrama</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>Advanced Data</td> <td>Rexhep Rada</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>Informatics System</td> <td>Nikos Frydas</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>10</td> <td>Advanced</td> <td>Donald</td> <td>Dr.</td> </tr> <tr> <td>11</td> <td>Engineering Project</td> <td>Ermelinda</td> <td>Prof. Asoc.</td> </tr> <tr> <td>12</td> <td>Research methods</td> <td>Maaruf Ali</td> <td>Dr.</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton se fushat specifike e kërkimore shkencore janë zbatuar për shpërndarjen e lëndëve tek stafi akademik.</p>	Lënda /Moduli	Pedagogu	Titulli/grada	1	Advanced Database	Rexhep Rada	Dr.	2	Advanced Machine	Arben Asllani	Prof. Asoc.	3	Advanced Java	Igli Hakrama	Dr.	4	Numerical Method	Ligor Nikolla	Prof. Asoc.	5	Software Testing	Ed lira Mertiri	Prof. Asoc.	6.	Mobile	Elton	Dr.	7	Advanced Software	Igli Hakrama	Dr.	8	Advanced Data	Rexhep Rada	Dr.	9	Informatics System	Nikos Frydas	Dr.	10	Advanced	Donald	Dr.	11	Engineering Project	Ermelinda	Prof. Asoc.	12	Research methods	Maaruf Ali	Dr.
Lënda /Moduli	Pedagogu	Titulli/grada																																																		
1	Advanced Database	Rexhep Rada	Dr.																																																	
2	Advanced Machine	Arben Asllani	Prof. Asoc.																																																	
3	Advanced Java	Igli Hakrama	Dr.																																																	
4	Numerical Method	Ligor Nikolla	Prof. Asoc.																																																	
5	Software Testing	Ed lira Mertiri	Prof. Asoc.																																																	
6.	Mobile	Elton	Dr.																																																	
7	Advanced Software	Igli Hakrama	Dr.																																																	
8	Advanced Data	Rexhep Rada	Dr.																																																	
9	Informatics System	Nikos Frydas	Dr.																																																	
10	Advanced	Donald	Dr.																																																	
11	Engineering Project	Ermelinda	Prof. Asoc.																																																	
12	Research methods	Maaruf Ali	Dr.																																																	

	<p>Metodat e mësimdhënies janë të larmishme e interaktive. Nga takimi që GVJ realizoi me studentët e këtij programi studimi, konstaton se ata përfshihen në procese interaktive të mësimi ku inkurajohen të punojnë në grup për detyra të shtëpisë apo projekte kurse, përpos punës hulumtuese individuale që secili prej tyre duhet të realizojë.</p> <p><i>Aneks Tabelat/ tabela 12.1, tabela 12.2</i></p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit.</i></p> <p><i>48 - CV të e stafit të angazhuar në mësimdhënie</i></p> <p><i>Takim me studentët e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë përpara provimit final për çdo lëndë ku ata japin opinionin e tyre në lidhje me mësimdhënien, literaturën dhe mund të lënë edhe komentet e tyre për problematika që kanë hasur. NJSBC përpunon këto rezultate në nivel njësie kryesore e bazë dhe më pas përcillen në njësinë bazë sipas programeve të studimit që secila ka. Në rast problematikash merren edhe masat e nevojshme.</p> <p><i>30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies</i></p> <p><i>33 - Modeli i pyetësorit për studentet.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të</p>	<p>Institucioni ka ngritur njësinë e brendshme e vlerësimit të cilësisë, e cila funksionon konform rregullores së universitetit dhe rregullores së brendshme të saj. Këtu theksohet se kjo njësi është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së programeve të studimit dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me njësitë kryesore e njësitë bazë. Sipas dokumentacionit vërejmë se janë realizuar aktivitetet të ndryshme në formë leksionesh të hapura apo workshope për ngritje kapacitetesh apo për tematika të reja të cilat stafi mund ti përfshijë në mësimdhënie. Duhet thënë se ky program studimi është ende i ri dhe tregues të matshëm mbi tema të caktuara të leksioneve dhe përfitimet prej tyre nuk mund të vlerësohen me saktësi.</p>

reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>03 - Rregullore e brendshme umt</p> <p>26 - Rregullore e NJSBC</p> <p>53 - Lista e leksioneve të hapura, ëorkshopeve, trajnimeve</p>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se Institucioni ka procedura dhe qasje pozitive drejt sigurimit të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet realizimit të leksioneve të hapura, përfshirjes në projekte e përfitimit nga marrëveshje me Universitete Evropiane.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Bazuar në rregulloren e Institucionit, si edhe në rregulloren e programit të studimit në nenin 21 përcaktohen procedura dhe kriteret e vlerësimit si më poshtë:</p> <p>21.1 Kriteret e vlerësimit të secilës formë kontrolli të dijeve përcaktohen në syllabuset e lëndëve dhe miratohen sipas procedurave të përkohshme në rregulloren e provimeve të UMT-së, të cilat i bëhen të ditur studentëve që me nisjen e programit të studimit;</p> <p>21.2 Vlerësimi i nje lënde mesimore bëhet:</p> <p>a) me provim me shkrim, me goje ose i kombinuar;</p> <p>b) me detyra kursi, kolegiume, projekte;</p> <p>c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi si praktika, etj.</p> <p>21.3 Gjatë procesit mësimor organizohen këto lloj provimesh:</p> <p>a) provimi i ndermjetëm. b) test i shkurtër. c) provim përfundimtar. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht</p>

	<p>kthehet në notë. Në format e kontrollit me shkrim. provimet bëhen të sekretuara.</p> <p>21.4 Për vlerësimin e njohurive të studentit përdoret sistemi i vlerësimit me JO (dhjete) nota (nga 4 tek 10, ku JO është vlerësimi maksimal). Me këtë sistem bëhet vlerësimi për të gjitha al- "aktivitetet e përshkruara në syllabus. Notat nga pesë e lart janë kaluese.</p> <p>21.5 Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së punimit të diplomës studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mesimore dhe në praktikë, duke marrë 102 kreditet e nevojshme.</p> <p>Për secilën lëndë pedagogu përkatës informon studentët në lidhje me peshën specifike për secilën nga format e sipërpërmendura.</p> <p><i>03 - Rregullore e brendshme umt</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se në orën e parë të leksionit secili pedagog informon studentët për syllabusin e lëndës me temat, literaturën si edhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në platformën Edu4Schools ku secili student ka akses vendosen materiale didaktike dhe syllabuset nga secili pedagog.</p> <p><i>13- Silabuset e lëndëve të programit të studimit</i></p> <p><i>Takime me staf/studentë në Insitucion</i></p> <p><i>GVB</i></p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në syllabuset e lëndëve GVJ konstaton se format e kontrollit të dijeve përfshijnë format e mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="616 1626 1366 1930"> <thead> <tr> <th data-bbox="616 1626 992 1733">Format e kontrollit të dijeve</th> <th data-bbox="992 1626 1366 1733">Msc Software Engineering Pjesa në % ndaj totalit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="616 1733 992 1832">Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive</td> <td data-bbox="992 1733 1366 1832">5 – 10 %</td> </tr> <tr> <td data-bbox="616 1832 992 1886">Plotësimi i detyrimeve</td> <td data-bbox="992 1832 1366 1886">10 – 20 %</td> </tr> <tr> <td data-bbox="616 1886 992 1930">Testimet gjatë vitit</td> <td data-bbox="992 1886 1366 1930">10 – 20 %</td> </tr> </tbody> </table>	Format e kontrollit të dijeve	Msc Software Engineering Pjesa në % ndaj totalit	Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	5 – 10 %	Plotësimi i detyrimeve	10 – 20 %	Testimet gjatë vitit	10 – 20 %
Format e kontrollit të dijeve	Msc Software Engineering Pjesa në % ndaj totalit								
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	5 – 10 %								
Plotësimi i detyrimeve	10 – 20 %								
Testimet gjatë vitit	10 – 20 %								



	Provimi përfundimtar	60 %		
	<b>Totali</b>	<b>100 %</b>		
	<p>Në varësi të specifikave të lëndëve pesha që zë secila formë është e ndryshme, por nuk kalon kufijtë e përcaktuar sipas tabelës së mësipërme</p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks Tabelat/Tabela 15</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ kostaton se nstitucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimin të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë ato bëhen publike dhe njihen nga studentët, duke garantuar zbatimin e tyre si dhe duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se për secilën lëndë testimi dhe vlerësimi i njohurive është i parashikuar në syllabusin e çdo lënde dhe është i vazhdueshëm gjatë gjithë vijueshmërisë së një lënde përgjatë semestrit. Nëpërmjet VSA "Për vlerësimin e vazhduar në Universitetin "Metropolitan Tirana", Institucioni garanton se vlerësimi i vazhduar realizohet sipas pikëzimit të mëposhtëm:</p> <p><i>5 pikë aktivizimi në auditor;</i></p> <p><i>5 pikë frekuentimi, i kategorizuar;</i></p> <p><i>60%frekuentim vlerësohet me 1 pikë;</i></p>

	<p>70% frekuentim vlerësohet me 2 pikë;</p> <p>80% frekuentim vlerësohet me 3 pikë;</p> <p>90% frekuentim vlerësohet me 4 pikë;</p> <p>100% frekuentim vlerësohet me 5 pikë;</p> <p>Frekuentimi i njohur nga Vlerësimi dhe Transferimi i krediteve është 2 pikë;</p> <p>5 pike Test I, që zhvillohet në javën V/VI;</p> <p>5 pike Test II, që zhvillohet në javën VIII/IX;</p> <p>Provimi i ndërmjetëm që zhvillohet në javën XI/XII vlerësohet me 20 pikë nëse lënda nuk parashikon detyrë kursi/laborator dhe vlerësohet me 10 pikë nëse lënda parashikon detyrë kursi/laborator, 10 pikë detyrë kursi/laborator. Detyra e kursit/laboratorët konvertohen në pikë si më sipër, vetëm kur vlerësohen së paku me notë kaluese 5.</p> <p>65 - VSA Per vleresimin e vazhduar ne UMT</p> <p>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstaton se platforma e përdorur si mjet për informim dhe alternativ për mësimdhënie UMT është Edu4Schools; platformë kjo që mund të shfrytëzohet edhe për testim online në lëndë të ndryshme. Në dokumentacion nuk ka të dhëna të matshme që tregojnë përdorimin e kësaj platforme për këtë.</p> <p>GVB</p> <p>Takime në Institucion</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar për një lëndë, e cila përkthehet në notë është një shumatore e detyrimeve që studenti ka plotësuar sipas parashikimit të kontrollit të dijeve në syllabus. Si formë e shkruar e kontrollit të dijeve janë testimet</p>



	<p>e ndërmjetme dhe testimi final. Realizimi i tyre rregullohet me anë të dokumentit “Rregullore e provimeve”.</p> <p><i>65 - VSA Per vleresimin e vazhduar ne UMT;</i></p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit;</i></p> <p><i>15 - Rregullore e provimeve;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se përpos njohjes me rezultatin nëpërmjet sistemit Edu4Shools, studentët kanë në dispozicion një afat 3 ditor për rishikim teze dhe diskutim me pedagogun me rezultatin dhe korrigjimin e realizuar. Përpos kësaj duhet thënë se kontrolli i vazhdueshëm i dijeve nëpërmjet detyrave e projekteve të kursit shoqërohet me feedback dhe komente nga ana e personelit akademik për përmirësime të nevojshme.</p> <p><i>65 - VSA Per vleresimin e vazhduar ne UMT;</i></p> <p><i>15 - Rregullore e provimeve;</i></p> <p><i>Takime staf/studentë të programit të studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Plagjiatura apo forma të ndryshme të kopjes nuk janë të lejuara në Institucion. Duke zbatuar Këshillin e Etikës, çdo pedagog ruan etikën gjatë zhvillimit të testeve të shkruara.</p> <p>Sipas “Rregullores së Provimeve”, nëse studenti konstatohet se është duke kopjuar menjëherë procesi i provimit ndërpritet dhe nota për këtë provim është 4. Nuk lejohet mbajtja e sendeve personale si smartphone apo pajisje të tjera gjatë procesit të provimit.</p> <p><i>15 - Rregullore e provimeve;</i></p> <p><i>38 - Rregullore e etikës;</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas “Rregullores së provimeve”, pedagogu i lëndës brenda një afati 3-ditor duhet të shpallë rezultatet e provimeve. Studenti ka të drejtën e rishikimit të korrigjimit dhe rezultatit për një afat po 3-ditor. Në përfundim të këtij afati pedagogu harton proces-verbalin dhe e dorëzon së bashku me tezat e korrigjuara në Departament.</p>

	<p>15 - Rregullore e provimeve; 18 - Rregullore e sekretarise mesimore;</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni garanton të drejtën e studentëve për tu njohur me rezultatin e provimeve dhe shikimin e vlerësimit për një afat 3-ditor nga shpallja e rezultateve. Njohja me korrigjimin bëhet duke u ballafaquar me komisionin e korrigjimit të përbërë nga dy persona ku sigurisht është edhe pedagogu i lëndës.</p> <p>15 - Rregullore e provimeve; 03 - Rregullore e brendshme umt; Takim me studentë të programit të studimit;</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nëse pas njohjes me korrigjimin e tezës dhe shpjegimit të komisionit të korrigjimit, studenti nuk bie dakord me vlerësimin, atëherë ai/a jo ka të drejtë të bëjë një kërkesë në formë ankimi dhe ta depozitojë në Departament. Për shqyrtimin e kërkesës përgjegjësi ngre një komision shqyrtimi të posaçëm i cili ndjek procedurat e mëtejshme të rivlerësimit dhe del me një rezultat përfundimtar.</p> <p>15 - Rregullore e provimeve; Takim me studentë të programit të studimit;</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se Institucioni ka mekanizma të parashikuara në rregullore për një proces të drejtë të realizimit të kontrollit të dijeve dhe një vlerësimi transparent në respekt të studentëve dhe të drejtave të tyre.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.4**

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, GVJ vëren se:</p> <p><i>6.1 Programi i studimit Master i Shkencave në "Software Engineering" synon formimin shkencor të profileve bashkëkohore të profesionisteve dhe studiuesve të rinj në fushën e inxhinierisë software, të aftë të përballen me sfidat që gjeneron tregu i punës.</i></p> <p><i>6.2 Për thellimin e njohurive gjate dy viteve te studimit, studenti pajiset me njohuri shkencore e aplikative që lidhen me fushën e teknologjisë së informacionit dhe në veçanti të zhvillimit software, duke zhvilluar projekte të ndryshme në fushën e programimit. Në menyrë progresive studenti njihet me shkallen e kompleksitetit që mbart projektimi, implementimi, testimi, shperndarja dhe mirëmbajtja e sistemeve software, të cilat kërkojnë njohurit dhe aftësit e një inxhinieri të specializuar në këtë drejtim.</i></p> <p><i>6.3 Nga ana tjetër, në aspektin etik, studentet formohen si një profil me impakt social dhe pergjegjësi profesionale në fushën e inxhinierisë software, të cilët mund të punësohen në sektore të ndryshëm si: bankat kompanitë e mëdha kombëtare e ndërkombëtare me departamentet e teknologjisë së informacionit në sektorin publik, universitete si edhe mund të operojnë si profesionist të lirë të fushës.</i></p> <p>Në përfundim të këtij programi studimi, i diplomuari është në gjendje të analizoje probleme e të japë zgjidhje në terma kompjuterike dhe inxhinierike, përmes një larmie instrumentesh. Shohim të përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi dhe zhvillimin e aftësive personale në fushën përkatëse.</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ konstaton se ky programi studimi ofrohet në gjuhën angleze. Përpos rregulloreve, edhe në planin mësimor e syllabuseve zgjedhja e lëndëve, organizimi i tyre nxit zhvillimin e aftësive teknologjike, projektimin, dizenjimin dhe testimin në fushën e zhvillimit të aplikacioneve. Disa nga lëndët karakterizuese janë:</p> <p><i>Programim i orientuar nga objektet i avancuar;</i></p>

	<p><i>Strukturë të dhënash e avancuar;</i></p> <p><i>Programim Mobile;</i></p> <p><i>Testimi dhe verifikimi i softwereve;</i></p> <p><i>Inxhinieri Software e avancuar etj;</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software;</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software;</i></p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton se sipas specifikave të çdo lënde, në konform me silabusin, në përfundim të cdo lënde studentët vlerësohen me notë, e cila është rezultat i shumatores së frekuentimit e aktivizimit mësimor, detyrë kursi/projekt si edhe provimit të ndërmjetëm dhe provimit përfundimtar. Nga takimet e realizuara me staf dhe studentë të këtij programi studimi, konstatojmë se sipas specifikave të çdo lënde, pedagogët theksojnë çështjet e konceptet më të rëndësishme që studentët duhet të kenë parasysh edhe me tej në studimet e tyre.</p> <p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit</i></p> <p><i>Takim me staf/studentë të programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të këtij programi studimi vërejmë se për çdo lëndë që janë pjesë e këtij programi studimi kemi të parashikuara orë laborator, përgjithësisht me një peshë 2 orë në javë për lëndë. Infrastruktura me ambiente dhe pajisje e mbështet realizimin e orëve të laboratorit, te cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Praktika mësimore, është prezentë në kurrikulën e programit të studimit në semestrin e dytë, të vitit të dytë të studimeve, e cila zhvillohet në kompani ku Institucioni ka lidhur marrëveshje paraprakisht. Nga takimi me stafin dhe studentët, konstatojmë se gjatë zhvillimit të mësimit krijohet një klimë e përshtatshme për bashkëpunim e punë në grup.</p>

<p>shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p><i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit</i>  <i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i>  <i>Takim me staf/studentë të programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik PAE dhe PAK inkurajohet vazhdimisht në realizimin e orëve dhe leksioneve të hapura mbi tema inovative e koncepte të reja shkencore. Bazuar në dokumentacion për këtë program studimi është Dr. I. H., i cili ka realizuar aktivitetet Future 2 Tech në diskutimin e çështjes Innovation.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon angazhimin e të gjithë stafit akademik në aktivitete, workshope e leksione të hapura.</i></b></p> <p><i>53 - Lista e leksioneve të hapura, workshopeve, trajnimeve</i>  <i>Takim me staf/studentë të programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni në rregulloren e tij, theksohet se studentët kanë të drejtë të kërkojnë financim nga Universiteti për realizimin e ideve dhe projekteve të tyre. Përpos kësaj studentët kanë mundësi që me idetë e tyre të marrin pjesë edhe në Inkubatorin e Biznesit për zhvillim në model biznesi të ideve novatore në teknologji e shkencë. Për këtë program studimi nuk janë konstatuar raste të tilla.</p> <p><b><i>GVJ rekomandon stafin dhe strukturat e Institucionit të inkurajojnë studentët të informohen dhe të përfitojnë nga këto mundësi që Institucioni ofron.</i></b></p> <p><i>03 - Rregullore e brendshme umt</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b><i>GVJ konkludon se programi i studimit zotëron elementët e nevojshëm për studentët në përfitimin e njohurive përkatëse për fushën e studimit.</i></b></p> <p><b><i>GVJ rekomandon angazhim më të lartë të stafit për realizimin e orëve të hapura, si edhe nxitjen e motivimin e studentëve të përfitojnë nga financimi i institucionit në mbështetje të zhvillimit të ideve dhe projekteve të tyre.</i></b></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
<b>Standardi III.5</b>				
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>GVJ konstaton se përpos mbylljes me sukses të detyrimeve për të gjithë lëndët, e praktikës mësimore, studenti duhet të realizojë një temë diplome i udhëhequr nga një mentor/pedagog i këtij programi studimi, i cili caktohet nga njësia bazë, me të cilin përcakton edhe temën. I gjithë ky proces bëhet i ditur për studentët në fillim të semestrit të fundit të studimeve, ku studentët zgjedhin mentorin e më pas temat.</p> <p><i>55 - Rregullore e temes se diplomes</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p>			
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Në vijim të procesit të shpjeguar më sipër, vijojmë se është përgjegjësi i njësisë bazë së bashku me përgjegjësien e programit të studimit që asistojnë studentët në përzgjedhjen e fushës dhe mentorin për temën e diplomës. Më pas procesin e asistimit të studentëve me materiale dhe ekspertizë i takon mentorit të diplomës, i cili ju vendos në dispozicion edhe formatin sipas të cilit studentët duhet të punojnë dhe i informon në lidhje me afatet për përmbylljen me sukses të këtij procesi.</p> <p><i>55 - Rregullore e temes se diplomes</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>44 - VSA pergj programesh dhe keshilltaret akademike</i></p>			
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha	<p>Për këtë program studimi nuk ka provim final përmbyllës, por përgatitje dhe prezantim e një teme diplome.</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p>			

<p>lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në rregulloren e temës së diplomës përcaktohet qartë roli i udhëheqësit të temës së diplomës si më poshtë:</p> <p><b>II. ZGJEDHJA E TEMES SË PUNIMIT TË DIPLOMËS</b></p> <p><i>Departamenti përkatës përgatit lista me titujt e temave të diplomave, të cilat u bëhen të njohur studentëve. Studenti bën zgjedhjen e temës në fushën në të cilën i intereson, në rast të kundërt i lihet e drejta atij për të propozuar një temë e cila do të shqyrtohet nëse mund të pranohet si e tillë nga Departamenti respektiv.</i></p> <p><b>III. UDHEHEQËSI I PUNIMIT TE DIPLOMES</b></p> <p><i>Udhëheqësi i punimit të diplomës ka për detyrë të drejtojë, të këshillojë dhe këshillojë studentin gjatë realizimit të punimit që nga zgjedhja e temës e deri në përfundim, të trajtojë problemet teoriko-praktike. të sugjerojë shfrytëzimin e literaturës, të përcaktojë afatet e punës dhe të kontrollojë realizimin e detyrave.</i></p> <p>Udhëheqës të punimit të diplomës mund të jenë pedagogët (të brendshëm apo të jashtëm), specialiste të tjerë të fushës të cilët kanë një eksperiencë të paktën 3-5 vjet.</p> <p><i>55 - Rregullore e temës së diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni dhe Fakulteti në rregulloret e tij, përcakton se studentët kanë të drejtë të shfrytëzojnë infrastrukturën në dispozicion për zhvillimin e matjeve, analizave për realizimin e temës së diplomës. Duhet thënë se për këtë program studimi ende nuk është diplomuar brezi i parë i të diplomuarve ndaj studentët nuk mund të dëshmojnë ende realizimin me sukses të këtij procesi.</p> <p><i>55 - Rregullore e temes se diplomës</i></p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Për këtë program studimi, mbrojtja e temës së diplomës realizohet përpara një komisioni me pedagogë nga stafi akademik. Secili prej tyre e vlerëson me notë, punimin në fund të prezantimit dhe nota përfundimtare është mesatare aritmetike e notës së propozuar nga secili anëtar i komisionit.</p> <p><i>63 - Vendim ngritje komisionesh per prezantim diplome dhe vleresim provim formimi</i></p> <p><i>55 - Rregullore e temes se diplomes</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, rezulton se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë sipas modelit të miratuar dhe suplementin përkatës. Kopja e plotë e programit të studimit nuk bën pjesë në dokumentacionin zyrtar që shoqëron diplomën dhe suplementin, por studentët mund të pajisen me një kopje të programit nëse janë të interesuar ta kenë atë.</p> <p><i>19 - Modeli i diplomes Master i Shkencave ne Software Engineering</i></p> <p><i>20 - Diploma Supplement Msc Inxhinieri Software</i></p> <p><i>18 - Rregullore e sekretarise mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Praktika zyrtare e Institucionit është të ruaj dokumentacionin e secilit student gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe sipas kërkesës së studentëve të japë informacion për to. Në përfundim të studimeve, studenti ka të drejtë të tërheqë dokumentacionin origjinal. Informacionet e studentëve, hidhen në regjistrin themeltar, i cili ruhet në sekretari, dhe të dhënat përcillen për çdo vit në QSHA.</p> <p><i>18 - Rregullore e sekretarise mesimore</i></p> <p><i>68 - Rregullore e arkivë protokollit</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se praktika e detyrimeve përmbyllëse për këtë program studimi, është e qartë, e rregulluar nëpërmjet dokumentacionit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të</i></p>

	<i>gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.6

**Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<p>Institucioni ka në dispozicion të këtij programi studimi infrastrukturë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Laboratori i Informatikës (Godina I)</li> <li>• Laboratori Multifunksional (Godina 1)</li> <li>• Laboratori i Informatikës (Godina 2 - 301)</li> <li>• Laboratori i Informatikës L1 (Godina 3 - L1)</li> <li>• Laboratori i Informatikës L2 (Godina 3 - L2)</li> </ul> <p><i>24 - Kapacitet Infrastrukturore</i> <i>24b - Raporti i MAS per godinen e re</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N/A
<b>Kriteri 3.</b> Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë	N/A

studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se Institucioni ka infrastrukturë të mjaftueshme për orfrimin e orëve të praktikës në laborator.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>					
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>					
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>				
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore	Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Staf i akademik për programin e studimit Master i Shkencave në "Software Engineering" sipas titujve dhe gradave, paraqitet si vijon:				
	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	0	0	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

46



të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Prof. Asoc.	2	1	2	2														
	Dr/Phd	1	1	5	1														
	Msc.	-	-	-	-														
	<b>Gjithsej</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>3</b>														
<p>GVJ konstaton se plotësohen kriteret ligjore për stafin akademik të angazhuar në këtë program ku i gjithë stafi është me kualifikim dhe gradë shkencore Dr.</p> <p>Gjithashtu, referuar CV të përfshira në DVV, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</p> <p><i>Aneks Tabela 6.2</i></p> <p><i>48 - CV të e stafit të angazhuar në mësimdhënie.</i></p>																			
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	<p>Nga analiza e dokumentacionit të DVV dhe atij plotësues të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mbulimi i ngarkesës për dy vitet akademike si vijon:</p>																		
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>600</td> <td>390</td> <td>210</td> <td>65% / 35%</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>1080</td> <td>810</td> <td>270</td> <td>75% / 25%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në këtë mënyrë, mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv per vitin akademik 2023-2024 (në raport me personelin akademik me kontratë) për programin e studimit është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, kurse për vitin akademik 2022-2023, stafi akademik <u>PAE nuk e mbulon ngarkesën e orëve mbi 70%,sipas ligjit në fuqi.</u></p> <p><i>Aneks Tabela 4 , 12.1</i></p>					Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	600	390	210	65% / 35%	2023-2024	1080	810	270
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)															
2022-2023	600	390	210	65% / 35%															
2023-2024	1080	810	270	75% / 25%															

	47 - <i>Ngarkesa mësimore për programin e studimit.</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar tabelave përmbledhëse në DVV si dhe nga verifikimet gjatë vizitës në institucion rezulton se përgjithësisht ka qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Nga takimet me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit ka lidhur kontratë pune me afat të pacaktuar për kategoritë Lektor dhe Profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. UMT garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore duke patur avantazh PAK i angazhuar edhe më parë.</p> <p><i>57 - Draft kontrate individuale pune - pedagog i brendshëm.</i></p> <p><i>58 - Draft kontrate individuale pune - pedagog i jashtëm.</i></p> <p><i>Takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të përcaktuara në Statutin e UMT dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Në Statut përcaktohet se kriteret e konkurrimit, propozohen nga njësitë përkatëse bazë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i UMT. Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me procedurën e rekrutimit të personelit akademik dhe e gjeti procedurën e aplikuar në përputhje me aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><i>01 - Statuti UMT.</i></p>

	<p>03 - Rregullore e brendshme UMT</p> <p>59 - Procedura e rekrutimit te personelit akademik</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka të angazhuar personel akademik ndihmës i cili ndjek dhe mbikëqyr mbarëvajtjen dhe zhvillimin e punëve të laboratorit si dhe kontribuon në mirëmbajtjen e laboratorëve informatikë.</p> <p>61 - Vendim mbi percaktimin e pergjegjesave te laboratoreve 23-24.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UMT ka në strukturën e tij Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik PAE dhe PAK dhe administrativ. Të dhënat e disponuar përditësohet vazhdimisht për çdo ndryshim të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program. Kjo zyrë ndjek gjithashtu të gjitha procedurat për rekrutimin e punonjësve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.</p> <p><i>Takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se UMT ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Praktika profesionale është pjesë e planit mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në "Software Engineering" e programuar me 12 kredite ECTS dhe zhvillohet në vitin e dytë (semestri i dytë). GVJ u informua se në funksion të praktikës profesionale, departamenti cakton udhëheqësin akademik nga PAE, i cili mbikëqyr studentin përgjatë gjithë procesit</p>

profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>16 - Rregullore e praktikave mesimore.</p> <p>17 - Dosje e praktikës mesimore.</p>			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<p>Në kuadër të marrëveshjeve për praktikën mesimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili kontrollon dhe informon mbi mbarëvajtjen e saj.</p> <p>16 - Rregullore e praktikave mesimore.</p> <p>62 - Kalendar, komisione provimesh dhe praktike.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor si dhe fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve. Ngarkesa mësimore realizohet kryesisht nga personeli akademik efektiv duke respektuar përgjithësisht detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi. Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirë përcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të UMT. GVJ konstaton se praktika profesionale përbën një element të rëndësishëm të formimit në këtë diplomë dhe zhvillohet në kompani/institucione me të cilat institucioni ka nënshkruar marrëveshje.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Universiteti “Metropolitan Tirana” ka vendosur në dispozicion të FSHKIT godinën , në katin e parë të së cilës ndodhet edhe biblioteka me sipërfaqe totale (2 ambiente) 110 m<sup>2</sup>. Ambientet e tjera të godinës janë auditorë, laboratorë e zyra për stafin akademik e ndihmës akademik të fakultetit.</p> <p>Ambientet janë të mirëmbajtura, me dritë, dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimimit. Numri i klasave për zhvillimin e mësimimit jepet në total për të gjithë FSHKIT dhe shpërndarja bëhet sipas numrit të studentëve. Nga stafi u pranua që ambientet janë të mjaftueshme edhe për personelin akademik edhe për studentët duke patur parasysh prurjet e deritanishme.</p> <p>Referuar DVV, UMT ofron mjedise për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse përkatësisht rreth 8.7 m<sup>2</sup> për student dhe 8,3 m<sup>2</sup> për stafin.</p> <p><i>24 - Kapacitet Infrastrukturore.</i></p> <p><i>Aneks Tabela 16</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e UMT konstatoi se disponohen klasa, laboratorë e mjedise të tjera, të cilat janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik disponon hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit të tij në shërbim të programit të studimit. Në ambientet e godinës ku zhvillohet procesi mësimor garantohet mundësia e punës në internet nëpërmjet lidhjes pa fije.</p> <p><i>24 - Kapacitet Infrastrukturore.</i></p> <p><i>Vizita në ambientet e institucionit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të</p>	<p>Në 2 laboratorët kompjuterikë të informatikës janë instaluar aplikacionet e nevojshme për simulimet dhe zhvillim Software si: Virtual Machine, Docker, VSCode,Eclipse, PHP, Apache(XAMPP), MySQL etj</p>



<p>përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>56 - Lista e Laboratoreve në përdorim të programeve të ofron FSHKIT.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT ka më shumë se një laborator të pajisur me pajisje informatike ku studentët aftësohen me konceptet e sistemeve të informacionit.</p> <p><i>56 - Lista e Laboratoreve në përdorim të programeve të ofron FSHKIT.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se UMT ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Në kuadër të marrëveshjeve për praktikat mësimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili kontrollon dhe informon mbi mbarëvajtjen e saj.</p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT.</i></p> <p><i>37 - Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar dhe të mirëmbajtur në funksion të zhvillimit cilësor të procesit mësimor. Institucioni plotëson kushtin e sipërfaqes së shfrytëzueshme për student. Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të</i></p>

	<i>objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Mirëmbajtja e pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik..</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme kryesisht në gjuhën angleze. Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion nga ana e pedagogëve edhe leksionet (të shkruara ose prezantime Powerpoint), të cilat përmbajnë një informacion më të përditësuar.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme pasqyron në ciklet e leksioneve dhe seancave praktike të rejtat që lidhen me lëndët përkatëse. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi se në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.  <i>13 - Silabuset e lëndëve të programit të studimit</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Universiteti "Metropolitan Tirana" ka në ambientet saj të Godinës 1, bibliotekën mësimore me 10 vende, e cila është në dispozicion të studentëve të FSHKIT, për studentët e ciklit Bachelor dhe Master. Biblioteka funksionon me orar të përshtatshëm për shfrytëzimin prej studentëve, me 2 turne dhe me orar të afishuar në hyrje të saj dhe të njoftuar në faqen e

	<p>universitetit. Biblioteka ka kushte të mira, kompjutera dhe me orar të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për studentët.</p> <p><i>64 - Inventari i bibliotekes.</i></p> <p><i>24 - Kapacitet Infrastrukturore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka kryesisht tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse rreth 140 tituj për të gjithë UMT, <i>por ato konsiderohen të pamjaftueshme për studentët e programit "Software Engineering"</i>. Fondi i saj nevojitet të pasurohet me tituj të rinj dhe revista teknike bashkëkohore, me qëllim mbështetjen e studentëve në punën kërkimore për detyrat e kursit në lëndët e programit të studimit dhe diplomat. <i>Literatura e vlefshme për studentët e programit është relativisht e ulët me gjithë përpyekjet që Universiteti "Metropolitan Tirana" bën për mirëmbajtjen e tyre.</i></p> <p><i>64 - Inventari i bibliotekes.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e Universitetit "Metropolitan Tirana" është krijuar mundësia për të gjithë studentët e programeve të studimit, që të shfrytëzojnë bibliotekën on-line në ambientet e bibliotekës së Universitetit "Metropolitan Tirana", me akses të barabartë, pa pagesë. Në faqen zyrtare të Universitetit "Metropolitan Tirana" jepen edhe informacionet e nevojshme për studentët dhe pedagogët.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion si dhe nga materialet në dosjen e vetëvlerësimit, u konstatua se në bibliotekën ku marrin shërbim studentët e programit të studimit "Software Engineering", ka një numër kompjuterësh në sallën e leximit me softe kompjuterike të përshtatshme për shfrytëzimin e literaturës së huaj.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në</p>	<p>Biblioteka e UMT funksionon me orare të përshtatshme për përdorimin e tyre prej studentëve të dy cikleve, me 2 turne , nga e hëna në të premte, nga ora 8.00-21.00. Shfrytëzimi i ambienteve të tyre prej studentëve është në nivel të përballueshëm për kapacitetet ekzistuese dhe masën e interesit që studentët paraqesin për shfrytëzimin e saj</p>

përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Në bibliotekë ka patur pasurime me tituj të rinj në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaj, por në dosjen e vetëvlerësimit ose RVB nuk jepen më shumë detaje në lidhje me përpjekjet që bëhen nga FSHKIT për rritjen e titujve të botimeve bashkëkohore të cilat konsiderohen relativisht të ulëta.</p> <p><i>Për vitet akademike në vazhdim duhet që UMT t'i kushtojë vëmendje shtimit të literaturës me botime të reja me qëllim që studentët e programit të studimit të "Software Engineering të marrin dije sa më të përditësuara.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Literatura bazë është e disponueshme në gjuhën angleze krzesisht në forme elektronike. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit edhe pasdite në orare të cilat përputhen me ato të zhvillimit të procesit mësimor. Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar. Për vitet akademike në vazhdim duhet që UMT t'i kushtojë vëmendje shtimit të literaturës me botime të reja me qëllim që studentët e programit të studimit të "Software Engineering të marrin dije sa më të përditësuara</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UMT në mbështetje të ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, mban në formë të shkruar 3 regjistra:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1) Regjistrin themeltar të studentëve;</li><li>2) Regjistrin e arritjeve akademike;</li><li>3) Regjistrin e diplomimeve dhe çertifikatave të lëshuara prej UMT;</li></ol> <p>Prej sekretarisë mësimore administrohen edhe</p> <ol style="list-style-type: none"><li>a. dosjet e regjistrimit të studentëve me dokumentacionin sipas kërkesave të MASR dhe akteve të brendshme rregullatorë;</li><li>b. dosjet me procesverbalet e vlerësimeve të studentëve sipas viteve akademike;</li><li>c. dosjet e transferimeve të studimeve dhe ç’regjistrimeve;</li></ol> <p>Krahas kësaj, UMT ka në shfrytëzim platformën elektronike “Edu4School” i cili u ofron përdoruesve (studentë e pedagogë) marrje informacionesh si : orari, rezultate provimesh, njoftime etj. Kjo platformë aksesohet me username e fjalëkalim nga secili anëtar i UMT.</p> <p><i>69 - Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohen informacionet dhe dokumentacioni përkatës që ka lidhje me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe për partnerët. Ky informacion administrohet në UMT, duke filluar prej rekrutimit të tyre, e në vazhdimësi, në ndjekje të progresit akademik të tyre. Për këtë angazhohen Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria mësimore dhe Departamentet/dekanati. Ky dokumentacion ruhet në hardcopy dhe elektronikisht për të gjithë kategoritë e lartpërmendura dhe përditësohet sa herë ka ndryshime gradash /titujsh ose pozicioni.</p>



	<i>03 - Rregullore e brendshme umt.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar për informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët (marrje të tyre në formë automatike), por strukturat e ndryshme si : zyra e financës, sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerëzore, departamentet etj, hartojnë informacione në formë tabelore ose shkresore dhe i ngarkojnë ato në platformë që të jenë të aksesueshme për përdoruesit e interesuar.  <i>03- Rregullore e Brendshme e UMT</i> <i>68 - Rregullore e arkivë protokollit</i>
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit është me karakter modular dhe ka të integruar platformën GotoMeeting dhe Edu4School që mundëson e-learning dhe komunikim interaktiv të studentëve e pedagogëve, për shkëmbim materialesh mësimore në format pdf, si dhe dorëzimin e detyrave të studentëve. Në faqen web të UMT gjendet informacioni për përdorimin e kësaj platforme.  <i>69 - Sistemi informatik i menaxhimit te studenteve.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Ky sistem menaxhimi krijon mundësinë që personeli akademik e administrativ të monitorohen prej departamenteve në kohë reale dhe veç kësaj lejon marrjen e dhënien e raportimeve individuale ose mbi bazë njësie bazë për organet drejtuese e titullarët e tyre.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare web të UMT: <a href="https://umt.edu.al">https://umt.edu.al</a> , jepet informacion për programet e studimit që ofrohen, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në këtë faqe ka informacion për fakultetet/programet e studimit, për projektet ku bën pjesë UMT, legjislacioni: rregulloret, statuti etj, biblioteka on-line, studentët, kërkimi shkencor e publikimet e stafit akademik etj
<b>Konkluzione</b>	<i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore</i>

	<i>dhe menaxhohet elektronikisht. Studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore u mundësohet hyrje e dedikuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në dosjen e vetëvlerësimit është depozituar dokument raport financiar, në lidhje me të ardhurat që UMT ka mundur të mbledhë në 5 vite, 2017-2022 për realizimin e misionit të saj. Këto të ardhura janë realizuar prej:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) të ardhurat nga tarifat e regjistrimit, shkollimit;</li> <li>2) të ardhurat prej granteve për kërkim e kontrata;</li> </ol> <p>Nga shifrat në raport duket qartë se burimi i të ardhurave është kryesisht tarifa e shkollimit, ndërsa të ardhurat prej granteve për kërkim zënë deri 3,3% të të ardhurave totale. Në raportin vjetor 2021-2022 deklarohen shpenzimet që UMT bën për realizimin e objektivave të saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpenzimet për paga, sigurime shoqërore 62%</li> <li>- shpenzime për qera, energji elektrike, ujë, shpenzime mirëmbajtjeje, shpenzime për materiale kancelarie, blerje librash etj. 29%</li> <li>- shpenzimet për Qendrën Kërkimore dhe Qendrën e Inovacionit, për pajisje laboratorike dhe trajnime të stafit akademik 9%</li> </ul> <p>Mbi bazën e këtyre shpenzimeve janë llogaritur edhe tarifat e shkollimit për të gjitha programet dhe nivelet e studimit.</p> <p>28 - Raporti Vjetor 2021-2022 74 - Raport Auditues Universiteti 2022</p>

	<i>73 - Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese 2022</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	<p>Raporti financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimet që UMT kryen për realizimin e misionit si IAL, është paraqitur si informacion në rang institucioni por jo në rang fakulteti. Në formë tabelore paraqiten të ardhurat për vitet: 2017-2022. Të ardhurat nga tarifat e shkollimit zënë peshën kryesore, 96-97% të ardhurave totale. Këto të ardhura përdoren prej UMT në financimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- paga e sigurime shoqërore për burimet njerëzore, bursa studentësh,</li> <li>- mbështetje e kërkimit shkencor,</li> <li>- organizime konferencash,</li> <li>- shpenzime operative: për qera, fatura energjie e uji,</li> <li>- blerje librash e material didaktike për laboratore etj.</li> </ul> <p><i>28 - Raporti Vjetor 2021-2022</i></p> <p><i>74 - Raport Auditues Universiteti 2022</i></p> <p><i>73 - Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese 2022</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<p>Sipas Zyrës së Financës , Raporti financiar është bërë çdo vit, auditohet nga ekspert i jashtëm dhe pasqyron burimet financiare të UMT. Gjithashtu detajohet sipas viteve edhe përdorimi i financimeve për paga, bursa, shpenzime operative, shpenzime për mbështetjen e stafit akademik në pjesëmarrje konferencash etj. Raporti mbahet në nivel institucioni, me të dhëna të pandara sipas fakulteteve.</p> <p><i>74 - Raport Auditues Universiteti 2022</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<p>Raporti mbahet në nivel institucioni, me të dhëna të pandara sipas fakulteteve. <b><i>Për një vlerësim më real të kostove të programeve të studimit, del e nevojshme që kontabiliteti të mbahet mbi bazë njësie kryesore ose njësie bazë.</i></b></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në rang institucioni, UMT dëshmon përmes raportit financiar , se përveç tarifave të shkollimit ka edhe burime të brendshme financimi, që emërtohen si “të ardhura nga grantet për kërkim dhe kontrata” por që nuk specifikohet më tej. Këto të ardhura janë të vogla krahasuar me totalin e të ardhurave nga institucioni, maksimumi rreth 3%. Kështu që UMT duhet të bëjë përpjekje për rritjen e kapaciteteve të vetëfinancimit me qëllim përmirësimin e situatës financiare dhe të mundësojë gjenerim të ardhurash për rritjen e cilësisë dhe standardeve në programet e studimit që ofron si dhe garanton zhvillimin e qëndrueshëm të IAL.</p> <p><i>75 - Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 5 vitet e fundit 2017-2022</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ nuk gjeti elementë të analizës së buxhetit në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit;</i></p> <p><i>UMT duhet të shtojë më tej përpjekjet për rritjen e të ardhurave nëpërmjet granteve të projekteve kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare si dhe prej shërbimeve trajnuese;</i></p> <p><i>GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

60

**Standardi V.1**

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UMT zbaton politika bazuar në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet rregullatore në fuqi. Mbështetur në statutin dhe rregulloret e brendshme të të gjitha niveleve të UMT, ka hartuar procedura që ndjekin zhvillimin e formimit akademik të studentëve sipas fushave të programeve të studimit nga fillimi i studimeve e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><i>03 - Rregullore e brendshme umt</i></p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përmes transparencës së informacionit, politikat dhe procedurat e zbatuara në procesin e formimit akademik të studentëve mundësojnë të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në hyrje dhe për gjithë studentët në rrugëtimin e tyre drejt diplomimit. Pranimi i studentëve në UMT në programin Master i Shkencave në Software Engineering bëhet sipas rregullores së programit të studimit Neni 13/14/15.</p> <p>UMT shpall kuotat për këtë program studimi dhe më pas pret studentë nga Shqipëria mjafton që të kenë diplomën Bachelor, të fituar në UMT ose IAL brenda vendit. Për studentët nga Kosova, Maqedonia , Serbia e Mali i Zi, diploma duhet të jetë njohur nga MASR. Kur numri i studentëve të interesuar i tejkalon kuotat, atëherë zhvillohet konkurs, nëpërmjet të cilit rankohen dhe shpallen fituesit. Kjo procedure bazohet tek barazia dhe transparenca. Më pas përveç informacionit që jepet në faqen zyrtare të UMT, çdo student ka mundësi që përmes adresës zyrtare të tij/saj të aksesojë sistemin “Edu4school” dhe të përfitojë informacione shtesë sipas nevojave.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p>



	<p><i>03 - Rregullore e brendshme umt</i></p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në propozimet që bëjnë njësitë bazë, Senati Akademik i UMT miraton kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe i bën ato publike përmes formave të ndryshme të njoftimit. Në hartimin e kriterëve për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve, departamenti bazohet në udhëzimet e MASR dhe aktet e brendshme rregullatore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga ana e UMT shpallja e kriterëve dhe procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve në programet e studimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme në mënyra të ndryshme: faqja zyrtare Web e UMT, statuti i UMT, Rregullorja, njoftimet. Gjithashtu informacioni mund të gjendet i shpallur edhe në ambientet e brendshme të fakulteteve të UMT në këndet e informacionit etj. Edhe procedurat e transferimit të studimeve, ekuivalentimeve e njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme kryhet përmes komisionit ad-hoc që njësia bazë ngre në fillim të çdo viti akademik për këto qëllime. Studentët mund të marrin informacion edhe në zyrën e sekretarisë mësimore dhe zyrën e studentit.</p> <p><i>72 - Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT</i></p> <p><i>03 - Rregullore e brendshme umt</i></p> <p><i>70 - Guida e studenteve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të</p>	<p>Senati Akademik i UMT miraton propozimet dhe kuotat në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe pranimit në programin e studimit Master i Shkencave në Software Engineering”. Këto propozime bazohen tek Udhëzimet e MASR në lidhje me kriterin e notës mesatare për ciklin e dytë të studimeve si dhe në kapacitetet e FSHKIT në lidhje me kuotat.</p>

veçanta të programit të studimit.	
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, GVJ vëren se i gjithë procesi i pranimit të kandidatëve për këtë program studimi udhëhiqet nga barazia, paanshmëria dhe meritokracia. Në këtë proces nuk ndalohen të aplikojnë kandidatë me aftësi të vecanta, nga pakicat dhe shtresat e marginalizuara. Institucioni ka parashikuar dhe përfshin këtu aplikimin për bursa dhe reduktim tarife për regjistrime të hershme dhe studentë ekselentë. Gjithashtu Institucioni ka edhe marrëveshje me Banken Credins, nga ku studentët mund të përfitojnë kredi studentore me 0% interes.</p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><a href="https://umt.edu.al/tarifate-dhe-bursat-e-studimit/">https://umt.edu.al/tarifate-dhe-bursat-e-studimit/</a></p>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Institucioni mirëpret studentë ndërkombëtarë për të gjithë programt e tij. Për këtë program studimi të ciklit të dytë, për këta studentë në kriteret e pranimit kërkohet edhe njehsimi i diplomës bachelor nga MASR.</p> <p><a href="https://umt.edu.al/studente-nderkombetare/">https://umt.edu.al/studente-nderkombetare/</a></p>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Institucioni ka parashikuar dhe përfshin këtu aplikimin për bursa dhe reduktim tarife për regjistrime të hershme dhe studentë ekselentë. Këtu parashikohet të përfitojnë nga bursa studimi studentë të cilët kanë vijueshmëri pozitive. Gjithashtu Institucioni ka edhe marrëveshje me Banken Credins, nga ku studentët mund të përfitojnë kredi studentore me 0% interes.</p> <p><a href="https://umt.edu.al/tarifate-dhe-bursat-e-studimit/">https://umt.edu.al/tarifate-dhe-bursat-e-studimit/</a></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkuldon se veprimtaria e FSHKIT zhvillohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</i></p>

	<p>-Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave vendimarrëse në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve.</p> <p>-Kriteret dhe procedurat e pranimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatën Akademik dhe aprovimit prej MAS.</p> <p>-Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku në faqen web të UMT ku publikohen kriteret për regjistrimin e kandidatëve të të gjithë kategorive.</p> <p>- UMT aplikon politikën specifike për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik në mënyra të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Duke konsultuar në faqen zyrtare web të UMT dokumenta si:</li> <li>- Statuti, Kodi i Etikës, rregulloret e programit të studimit etj.</li> <li>- Në takimet e para me pedagogët e lëndëve, ata njihen me programin e lëndës, detyrimet që duhet të përmbushin për futjen në provim,</li> <li>- Mënyrat e vlerësimit, riprovimeve, kalimi në vitin pasardhës, transferimin e studimeve etj</li> <li>- Procedurën e diplomimit etj.</li> <li>- Duke u konsultuar me zyrën e studentit, sekretarinë mësimore etj.</li> </ul>

	<p><i>03 - Rregullore e brendshme umt;</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software ;</i></p> <p><i>72 - Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Përmes dokumentave bazë si Statuti i UMT, dhe Rregulloret e PS që aksesohen online, studentët marrin informacion të mjaftueshëm për procedurat e njohjes së studimeve të mëparshme ose transferimit të studimeve. Për informacion më të detajuar, studenti drejtohet edhe në zyrën e studentit, sekretarinë mësimore ose departamentin përkatës. Departamenti ngre komisionin ad-hoc dhe kryen procedurën e ekuivalentimit të krediteve për njohjen e studimeve të mëparshme, transferimit të studimeve ose në rastin kur studentët kanë kryer mobilitetpërmes programeve e marrëveshjeve që UMT ka me universitetet jashtë ose brenda vendit. Nisur nga jetëgjatësia e shkurtër e programit të studimit nuk kemi ë dhëna për studentë të transferuar, në mënyrë që të tregojë edhe zbatimin e procedurave në mënyrë eficente.</p> <p><i>Aneks Tabelat;</i></p> <p><i>72 - Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit në programet e UMT;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara prej tyre gjatë zhvillimit të programit të studimit. Ky informacion merret në mënyra të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Nga rregullorja e FSHKIT dhe rregullorja e programit të studimit, që aksesohen në faqen zyrtare web të UMT;</li> <li>2) Nga pedagogu i lëndës;</li> <li>3) Nga sekretaria mësimore;</li> </ol> <p>Këto informacione janë në përputhje me specifikimet e bëra në syllabuset e lëndëve;</p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT</i></p>

	<i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Kritere dhe procedura janë përcaktuar qartë edhe për punimin e diplomës. Këtë informacion studentit e merr nga rregullorja e FSHKIT, rregullorja e temës së diplomës dhe rregullorja e programit të studimit. Studenti diplomohet me punimin e një teme diplome, nëse studentit ka fituar të gjitha kreditet prej lëndëve të programit të studimit dhe praktikës. Punimi i Diplomës ka 18 kredite dhe duhet të plotësojë kushtet që specifikohen në rregulloren e PS. Informacioni merret edhe në sekretarinë mësimore, zyrën e mbështetjes së studentit.</p> <p><i>4 - Rregullore FSHKIT</i></p> <p><i>09 - Rregullore e programit te studimit Msc Ing Software</i></p> <p><i>55 - Rregullore e temes se diplomes</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>UMT në mënyrë periodike para plotësimit të formularit të aplikimit prej studentëve, organizon takime promovuese duke ftuar në ambientet e saj studentë të mundshëm në të ardhmen. Gjithashtu organizon aktivitete e takime të hapura, ditët e informimit si dhe përgatit udhëzues, fletëpalosje në ndihmë të informacionit për studentët. Në këto aktivitete angazhohen anëtarët e departamenteve, anëtarë të zyrës së Karrierës e Alumni etj.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstatoi se studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Institucioni ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët informohen mbi procedurat e ndryshme që duhet të ndjekin për mbarëvajtjen e studimeve dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Pedagogët u bëjnë të njohur syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



				X
--	--	--	--	---

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Informacionin për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, çdo student në UMT e merr në faqen zyrtare web të universitetit, e merr në takimin e parë informues në fillim të studimeve , por mund ta marrë edhe prej pjesës së stafit të dedikuar punës me studentin në nivel UMT ose FSHKIT.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><i>11 - Plani mesimor Msc Ing. Software</i></p> <p><i>10 - Të dhënat e përgjithshme të programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga takimi me studentët doli e qartë se informacioni që ata kanë nevojë të marrin në lidhje lëndët, modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese merren gradualisht prej pedagogëve të lëndës por edhe në mënyrë të plotë mund të merren prej informacionit në zyrën e studentit, nga platforma “Edu4school” ose në faqen zyrtare.</p> <p><i>Takim me studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UMT organizon çdo vit Panairin e Karrierës, ku studentët dhe përfaqësues nga biznesi lokal mund të takohen për të identifikuar ofertën që ka tregu aktual i punës, ku sigurisht edhe kompani apo biznese me fokus zhvillimin e software janë pjesë. Përpos kësaj zyra e karrierës dhe Alumni organizon aktivitetet që kanë të bëjnë me tranzicionin e studentëve drejt tregut të punës, ku paraprakisht studentët duhet të regjistrohen. Një plus për këtë zyrë është edhe lidhja që kjo zyrë krijon mes studentëve normal dhe alumni, për të ndihmuar në proceset akademike dhe në tregun e punës.</p>

	<p>Gjithsesi për këtë program studimi nuk mund të konkludojmë për të dhëna të matshme sepse është një program i ri, ne vitin e dytë të studimeve dhe ende pret të diplomojë brezin e parë të studentëve.</p> <p><i>40 - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT</i></p> <p><i>37 - Lista e kompanive me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>UMT me anë të sistemit të menaxhimit dhe informimit, në kanalën “studentët” gjejnë informacionin e përditësuar për të cilin ata kanë nevojë në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën etj. Nga ana tjetër prej faqes zyrtare web apo edhe në stendat informuese merret informacioni për infrastrukturën dhe shërbimet e UMT në lidhje dhe në funksion të procesit mësimor. Java e parë i dedikohet orientimit të studentëve për programin e studimit, që e kombinuar me guidën e studentit, plotësojnë më së miri të drejtën dhe kërkesat e studentëve për informacion në UMT.</p> <p><a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a></p> <p><i>Takim me studentët</i></p> <p><i>70 - Guida e studenteve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ vëren se sistemi i menaxhimit të brendshëm përmes “Edu4school”, që jep informacione të përditësuara në lidhje me procesin mësimor të gjithë programeve të studimit, është i aksesueshëm prej studentëve nëpërmjet llogarisë personale të tyre të krijuar prej UMT dhe që është aktive që në fillim të studimeve dhe për sa kohë gëzon statusin student. Duke qenë se është një sistem që mund të aksesohet on-line dhe në distancë, bëhet lehtësisht i aksesueshëm dhe shumë i dobishëm për studentët e gjithë programeve të studimit. Aktiviteti mësimor në kushtet e pandemisë u mundësua përmes platformës “Gotomeeting”, ku studentët zhvilluan mësimin online, aksesuan materialet didaktike dhe komunikimin interaktiv me pedagogët.</p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Një rol të rëndësishëm në informimin e vazhdueshëm të studentëve luan faqja web e institucionit si edhe sekretaria mësimore. Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës &amp; Alumnit.</i></p> <p><i>Sistemi i informacionit "Edu4school", jep informacione të përditësuara në lidhje me procesin mësimor dhe afron një akses të individualizuar në sistem dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë..</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga materiali i paraqitur prej UMT në dosjen e akreditimit, është e qartë se institucioni mban statistika vjetore (mbi bazë vitesh akademike) në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, të ç’regjistruar, raportin përkatës meshkuj/femra në çdo program studimi, moshën e studentëve. Këto të dhëna statistikore prodhohen prej sekretarisë mësimore dhe përmes raporteve vjetore të NjSBC raportohen në MASR dhe disponohen edhe nga fakultetet dhe departamentet. Për këtë program studimi ende nuk ka të dhëna mbi studentët e parë të diplomuar sepse është një program i ri studimi.</p> <p><i>54 - Raport mbi përgatitjen e studenteve te vitit te pare te regjistruar ne vitin shkollor 2023-2024</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Tabelat e përpiluara nga Sekretaria Mësimore kanë informacion statistikor të detajuar, mbi bazë vitesh akademike, në lidhje me studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të regjistruar në çdo program studimi;</li> <li>• Të diplomuar në çdo program studimi;</li> <li>• Të tërhequr ose të larguar para përfundimit të programit të studimit , ç’regjistruar etj , në çdo program studimi;</li> </ul> <p>Në lidhje me këtë program studimi numri i studentëve është si më poshtë:</p> <p>Viti akademik 2022-2023 5 studentë;</p> <p>Viti akademik 2023-2024 13 studentë;</p> <p>GVJ vëren se numri i të regjistruarve është rritur ndjeshëm, si edhe cilësia është përmirësuar, ku nota mesatare e studentëve të regjistruar ka shkuar nga 7.2 në 8.01.</p> <p><i>54 - Raport mbi pergatitjen e studenteve te vitit te pare te rregjistruar ne vitin shkollor 2023-2024</i></p> <p><i>Aneks Tabelat</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit realizohet përmes platformës “Edu4school” dhe mundëson aksesimin dhe verifikimin e informacionit për studentët dhe ecurinë e tyre në programin e studimit në mënyrë të lehtë por të sigurtë, duke u mbështetur në parimin e konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Ky informacion mund të merret në kohë reale prej studentëve në sistem ose në formë të printuar pranë sekretarisë mësimore, personalisht ose përmes personave të autorizuar, konform akteve ligjore në fuqi.</p> <p><i>my.umt.edu.al</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin</p>	<p>Institucioni për mirëfunksionimin e tij ka miratuar një sërë rregulloresh në nivel jo vetëm institucional, por edhe në nivel njësisht kryesore e bazë, si edhe në nivel zyrash administrative. Sistemi i brendshëm i përdorimit për menaxhimin e</p>

<p>(sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>informacioni është Edu4Schools, i cili i jep akse të gjithë aktorëve për hedhje dhe menaxhim informacioni dhe funksionimi është i rregulluar. Nga dokumentacioni dhe RVB, nuk vërejmë dokumentacion i cili mbështet me akte kontroll auditues për menaxhimin dhe mbajtjen e informacionit në sekretari, por edhe për funksionimin e sistemit të brendshëm në hedhjen e të dhënave dhe menaxhimin e tyre.</p> <p><i><b>GVJ rekomandon dokumentimin e procesit të kontrollit për saktësinë e hedhjes së informacionit dhe menaxhimin e tij nga njësitë përgjegjëse duke përfshirë këtu sekretaritë mësimore, sistemin e brendshëm të informacionit etj.</b></i></p> <p><i>18 - Rregullore e sekretarise mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Nëpërmjet dokumentacionit GVJ konstaton se në raportin vjetor të njësisë bazë për vitin akademik 2022-2023 nuk ka informacion të dedikuar në lidhje me cilësinë e studentëve dhe shkallën e punësimit të tyre. Ky lloj informacioni, në këtë institucion mblidhet nga Zyra e Karrierës dhe Alumni për shkallën e punësimit dhe zyra e cilësisë dhe kurrikulave për cilësinë akademike të studentëve. Sic kemi theksuar edhe më sipër, ky është një program i ri studimi, ku brezi i parë i studentëve ende nuk është diplomuar dhe informacionet analitike mungojnë.</p> <p><i><b>GVJ rekomandon gjithësesi që në raportin analitik vjetor të njësisë bazë të përfshihet informacion në lidhje me cilësinë akademike të studentëve dhe shkallën e punësimit në të ardhmen edhe pse kjo nuk është detyrë e drejtpërdrejtë e njësisë bazë.</b></i></p> <p><i>Raporti vjetor për DIK për vitin akademik 2022-2023</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se kryesisht Institucioni ka dhe mbledh informacion në lidhje me studentët, e dokumenton atë edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit. Sekretaria mësimore është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave, në të përpunohen të dhënat si në format fizik (regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave) ashtu dhe në format elektronik, ajo disponon gjithë</i></p>



	<p>informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>GVJ rekomandon dokumentimin e procesit të kontrollit për saktësinë e hedhjes së informacionit dhe menaxhimin e tij nga njësitë përgjegjëse duke përfshirë këtu sekretaritetë mësimore, sistemin e brendshëm të informacionit etj.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon gjithsesi që në raportin analitik vjetor të njësisë bazë të përfshihet informacion në lidhje me cilësinë akademike të studentëve dhe shkallën e punësimit në të ardhmen edhe pse kjo nuk është detyrë e drejtpërdrejtë e njësisë bazë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në zbatim ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e RSH” dhe në mbështetje të Statutit të UMT, studentët kanë të drejtë të jenë pjesë e vendimmarrjes në të gjitha nivelet. Ata kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, NJSBC, komisionet e vlerësimit të brendshëm, zgjedhur përmes një procesi zgjedhor në rang institucioni. Nga ana tjetër Këshillat Studentore janë krijuar mbi bazë njësie kryesore dhe nga ana e UMT tentohet që studentët të bëhen pjesë e gjithë komisioneve.</p> <p><i>07 - Vendimi per ngritjen e GVB</i></p> <p><i>25 - VSA mbi miratimin e NJSBC</i></p> <p><i>41 - Përfshirja e studenteve ne organet kolegjiale</i></p> <p><i>Takim me studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët si dhe bazuar në dokumentacionin e dosjes së akreditimit, mund të konfirmojmë</p>

<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>se në UMT studentët përfshihen në vendimmarrje përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre në nivele të ndryshme të institucionit (Senat Akademik, Njsbc, komisione të vlerësimeve të brendshme në nivel departamenti e fakulteti etj, ku diskutohen çështje të rëndësishme si: Buxheti i UMT, adresimi i kërkesave të studentëve etj.). Studentët gjithashtu marrin pjesë sistematikisht në vlerësimin e procesit akademik, në pyetësin për procesin akademik që zhvillohet 2 herë në vit, nëpërmjet shprehjes së mendimeve të tyre dhe këshillimit e sugjerimit për përmirësimin e punës. DIK merr parasysh vërejtjet dhe komentet e dhëna në pyetësor duke i bërë pjesë të diskutimit në departament me qëllim që rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Ky proces e bën vendimmarrjen e studentëve jo vetëm të matshëm por edhe të frytshëm.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><i>41 - Përfshirja e studenteve ne organet kolegjiale</i></p> <p><i>25 - VSA mbi miratimin e NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Pyetësori i çdo fund semestri që UMT organizon dhe marrja parasysh e mendimit të tyre në planin e masave, garanton që pjesëmarrja e studentëve në rishikimin e programeve të studimit të jetë reale.</p> <p><i>30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies</i></p> <p><i>Takim me studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe</p>	<p>Nga takimi me studentët u bë e qartë se atyre u jepet mundësia të kërkojnë të drejtën e tyre në lidhje me vlerësimin e kontrollit të dijes mbi baza barazie, ndershmërie dhe që respekton të drejtën e ruajtjes së të dhënave personale. Atyre u jepet mundësia e ankimimit, e rishikimit të provimit dhe rivlerësimit nga komision i paanshëm. Kjo procedurë është e shpjeguar në rregulloren e programit të studimit dhe zbatohet me rigorozitet nga stafi akademik. Nga ana tjetër ata mund të shprehin</p>

reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	mendimin e tyre në pyetëtorët, në rubrikën që ka lidhje me barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.			
	30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies Takim me studentët 09 - Rregullore e programit të studimit Msc Ing Software			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Komisionin për Vlerësimin Institucional, si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB. Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të UMT si dhe nëpërmjet përpunimit të pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët.</i></p> <p><i>Vlerësimi i dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimit. Konstatohet se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të studentëve nga ana e pedagogëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrjnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	Në Statutin e UMT njihet e drejta e studentit për informim dhe në rregulloret e brendshme të Fakultetit dhe programit të studimit Master i Shkencave në "Software Engineering" shpjegohen procedurat, që institucioni përmes strukturave specifike që ka ngritur, garanton shërbim mbi bazë barazie dhe

<p>ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>konform akteve rregullatore të UMT. Dy zyrat të cilat e kryejnë pjesën më të madhe të këtij procesi janë:</p> <p>Zyra e informimit dhe këshillimit të karrierës dhe zyra e shërbimit ndaj studentit.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në UMT janë në funksionim struktura që kanë si detyrë kryesore dhënien e informacionit, orientimin dhe shërbimet ndaj studentëve. Përveç sekretarisë mësimore, në UMT veprojnë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e informimit dhe këshillimit të karierrës</li> <li>- Zyra e shërbimit ndaj studentëve,</li> <li>- Këshilltarët akademikë</li> </ul> <p>Qëllimi i funksionit të këtyre strukturave është të ndjekin në vazhdimësi (prej hyrjes deri në përfundim të studimeve) ecurinë e studentëve dhe i informojnë ata në lidhje me çështje të zhvillimit të programit të studimit, marrin informacion për shqetësimet dhe problemet e studentëve dhe kthejnë përgjigje brenda afateve të vendosura në rregulloret e institucionit. Nga anketimi i studentëve, rezulton se më shumë se 80% e tyre, janë ndjerë të mbështetur nga strukturat e UMT si sekretaria mësimore, këshilltari akademik, shërbimi ndaj studentit, zyra IT etj.</p> <p><i>01 - STATUTI UMT</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe</p>	<p>Studentët e regjistruar në UMT, marrin pranë sekretarisë mësimore kontakt zyrtar për komunikimin në vazhdimësi. Ky kontakt (adresë email-i) shërben edhe për aksesin e studentëve në platformën “Edu4school” ku në mënyrë periodike merren informacione për zhvillimin e programit studimor. Në shërbim të studentëve është Zyra e Karrierës dhe Alumni, e cila angazhohet në mënyrë periodike për dhënien e informacionit të nevojshëm në rrugëtimin e studentëve prej fillimit e deri në përfundim të programit të studimit. Informacioni që kjo njësi jep, ka rëndësi në lidhje me orientimin e tyre në procesin mësimor, praktikën profesionale, diplomimin si dhe në</p>



orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	mbështetjen e institucionit për integrimin e shpejtë dhe efektiv në tregun e punës.  <i>70 - Guida e studenteve</i> <i>40 - Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Karrierës UMT</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga takimi me specialistët e kësaj zyre u evidentua përpjekja e vazhdueshme që bëhet prej UMT në ndjekjen e karrierës së studentëve të diplomuar dhe në UMT ky proces është përgjegjësi e Zyrës së Karrierës dhe Alumni. Nga diskutimi me këtë njësi, u evidentua se mbahen statistika për ecurinë profesionale të studentëve të diplomuar, por nga materialet e depozituara në dosjen e vetëvlerësimit (foto me aktivitetet “alumni” në UMT) <i>del nevoja e intensifikimit të përpjekjeve për krijimin e një database me të dhënat e ecurisë profesionale të të diplomuarve, që do të ishte promovimi më efektiv i programit të studimit.</i>  <i>Takim me stafin</i> <i>51 - Aktivitetet e Zyrës ALUMNI</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, kontribuon në drejtim të punësimit të të diplomuarve, duke shpërndarë për studentët e diplomuar informacione mbi ofertat e tregut të punës, mundësinë e praktikave, intershipeve, kualifikimeve etj. Një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit, këshillimit dhe asistimit të tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, luajnë dhe pedagogët e lëndëve;</i> <i>GVJ konkludon se UMT ka procedurat për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave. GVJ rekomandon krijimin e një database me të dhënat e ecurisë profesionale të të diplomuarve, që do të ishte promovimi më efektiv i programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik në universitete jashtë vendit.</p> <p>GVJ konstatoi se UMT e zhvillon programin e studimit Master i Shkencave në "Software Engineering" në përputhje me standartet e vendosura nga UMT dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit e duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online).</p> <p><i>35 - Marrëveshje në kuadër të Programit Erasmus+.</i></p> <p><i>53 - Lista e leksioneve të hapura, ëorkshopeve, trajnimeve ... etj.</i></p> <p><i>01 - STATUTI UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti Inxhinieri Kompjuterike është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në "Software Engineering". Ai është përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies nga ana e personelit akademik. Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik drejtohet nga NjSBC. Kjo njësi koordinon realizimin e procesit të vetëvlerësimit të institucionit nëpërmjet mekanizmave përkatës si anketimi i studentëve. GVJ konstatoi</p>

	<p>se këta elementë integrohen dhe në raportet vjetore të Departamentit Inxhinieri Kompjuterike.</p> <p><i>27 - Politikat e cilesise ne UMT</i></p> <p><i>26 - Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>28 - Raporti Vjetor 2021-2022</i></p> <p><i>04 - Rregullore FSHKIT.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë përpara përfundimit të çdo semestri. NJBSC shprehet se kur ka pasur ankimime ato janë trajtuar.</p> <p><i>33 - Modeli i pyetësorit për studentet</i></p> <p><i>30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në Universitetit “Metropolitan Tirana”. Monitorimi dhe vlerësimi i performances se personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Ai vlerëson performancën e personelit akademik me anë të formularit të vlerësimit. NJBSC analizon vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe gjeneron një raport individual për secilin anëtar të stafit akademik. Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të Universitetit “Metropolitan Tirana”.</p> <p><i>27 - Politikat e cilesisë në UMT</i></p> <p><i>26 - Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për</p>	<p>GVJ, në bazë të dokumentave konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar.</p>

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	33 - Modeli i pyetësorit për studentet 28 - Raporti Vjetor 2021-2022.			
<b>Konkluzione</b>	Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NjSBC. GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies e të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. Elementë të caktuar të vlerësimit integrohen dhe në raportet vjetore të institucionit. Rezultatet përfundimtare të vlerësimeve janë objekt i diskutimeve në Departament.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>UMT mbështetur në Statutin e tij dhe në funksion të arritjes së misionit, zbaton politika në përputhje me ligjin 80/2015 me qëllim rritjen e cilësisë së produktit të programeve të studimit që zhvillon. Për garantimin dhe sigurinë e cilësisë, UMT ka ngritur një strukturë të posaçme, NJSBC që operon sipas akteve rregullatorë të brendshme dhe në përputhje me kornizën ligjore e nënligjore në fuqi. Për garantimin e cilësisë ndihmojnë edhe</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senati Akademik;</li> <li>- Komisionin e Vlerësimit Institucional;</li> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC);</li> <li>- Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave;</li> <li>- Departamenti</li> </ul>

	<i>26 - Rregullore e NJSBC.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sipas dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit dhe takimeve në institucion, UMT ka ngritur dhe ka funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila funksionon në nivel institucioni dhe me përbërje nga të gjitha njësitë kryesore. Qëllimi kryesor i kësaj njësie është zbatimi i strategjisë së UMT për rritjen e vazhdueshme të cilësisë, duke vlerësuar periodikisht procesin akademik, financiar dhe administrativ, proces ku përfshihen: stafi akademik, stafi ndihmës akademik, ekspertë të jashtëm dhe studentët. Raportet vjetore, mbi veprimtarinë akademike e financiare të UMT, të kësaj njësie paraqiten e miratohen në Senatin Akademik, e më pas dërgohen në MASR.  <i>26 - Rregullore e NJSBC.</i> <i>27 - Politikat e cilesise ne UMT.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UMT i është nënshtruar periodikisht proceseve të vlerësimit të brendshëm e të jashtëm si dhe akreditimeve institucionale e për programet e studimit që ofron. Këto procese kryhen sipas kornizës ligjore në fuqi dhe janë një mjet efektiv për arritjen dhe sigurimin e cilësisë përmes vlerësimesh analitike e krahasuese të ekspertëve të jashtëm të kësaj fushe me qëllim promovimin e rasteve e metodave të mira që rrisin cilësinë e produktit
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë,	Nga ana e NJSBC në UMT bëhen përpjekje të mira për të zbatuar politikat e hartuara nga institucioni dhe përkthimit të tyre në procedura periodike për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që UMT ofron. Përmes rregulloreve, përmirësimit të vazhdueshëm të formës dhe përmbajtjes së pyetësorëve, si dhe ndërveprimit me studentët, kjo njësi synon krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional dhe ndërgjegjësimin e përfshirjen e gjithë faktorëve dhe aktorëve të brendshëm të institucionit, pasi vetëm kështu garantohet arritja e misionit të UMT.

institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.									
<b>Konkluzione</b>	<i>Organizimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UMT garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në UMT funksionon NJSBC në nivel institucioni. NJSBC në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin;</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen</p>	<p>Nga ana e UMT përdoren mekanizma e procese formale që dokumentohen në lidhje me shqyrtimin, ndryshimin, miratimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, ndër të cilët përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportet e NJSBC për pyetësorët e studentëve;</li> <li>- Raportet e DIK dhe Njesisë kryesore FSHKIT;</li> <li>- Analiza e punës hartuar prej NJSBC;</li> <li>- Organizimi i aktiviteteve ku fokus është studenti dhe tregu i punës, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e pritshmëritë e tij (tregut të punës).</li> </ul> <p>26 - Rregullore e NJSBC.</p> <p>27 - Politikat e cilesise ne UMT.</p> <p>28 - Raporti Vjetor 2021-2022</p>



<p>dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga ana e Departamentit Inxhinieri Kompjuterike, pas diskutimit të raporteve me rezultatet e anketimit të studentëve, hartohet një plan masash me qëllim adresimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky plan masash raportohet dhe në Rektorat ku pritet miratimi prej Senatit Akademik në lidhje me masat e propozuara.</p> <p><i>28 - Raporti Vjetor 2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UMT përmes Senatit Akademik ka miratuar krijimin e dy instrumentave që vlerësojnë ecurinë e programeve të studimit në nivel institucioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. pyetësorin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies nga stafi akademik dhe cilësinë e shërbimeve të dhëna prej stafit administrativ;</li> <li>2. Procesi vetëvlerësues i stafit akademik si dhe vlerësimi i brendshëm në nivel institucioni që përgatitet nga NJSBC me të dhënat e marra nga departamentet dhe studentët;</li> </ol> <p>Metodologjia e përpunimit të të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve të pyetësorëve bazohet kryesisht në të dhënat sasiore.</p> <p><i>26 - Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>67 - Vlerësimi i performances dhe ngarkesës vjetore.</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Studentëve u mundësohet të jenë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit edhe duke ofruar mendimet e tyre nëpërmjet përfshirjes në procesin e vlerësimin të programit të studimit (pjesë e GVB), Këshillit Studentor, pjesëmarrjes në Senatin Akademik, GVJ u informua se Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, administron statistika të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në UMT e cila shërben si një bazë e mirë për vlerësimin e shkallës së përgatitjes profesionale të studentëve të diplomuar. Veç kësaj kjo zyrë organizon takime mes studentësh të diplomuar me studentët aktualë me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të punësimit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si dhe organizon pyetësorë me studentët e diplomuar dhe eventualisht të punësuar. Një aspekt tjetër është dhe mbështetja e UMT nga studentët e diplomuar (Alumni) duke tërhequr vazhdimisht mendimin e tyre mbi hapat që duhet të ndërmarrë UMT apo duke ndihmuar studentët aktualë në studimet e tyre dhe në zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p><i>71 - Model pyetësor per studentet e diplomuar.</i> <i>51 - Aktivitetet e Zyrës ALUMNI.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Master i Shkencave në "Software Enginnering". Nga ana e Departamentit hartohen raporte vjetore, ndërsa në nivel institucioni përpilohen raporte të cilat i transmetohen MAS.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UMT për të garantuar politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe në nivel njësie bazë, është ngritur dhe funksionon grupi i sigurimit të cilësisë me aktorët e brendshëm si stafi akademik, stafi administrativ e studentët.</p> <p><i>Me qëllim krijimin e një kulture për vetëvlerësim të brendshëm real e të dobishëm duhet të përfshirjen edhe më shume aktorëve të jashtëm të interesuar drejtpërdrejt në cilësinë e produktit që jep programi i studimit Master i Shkencave në “Software Engineering”, siç mund të jenë përfaqësues nga biznesi dhe titullarët e stafeve nga fusha e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.</i></p> <p>Gjithë procesi funksionon bazuar në rregulloret përkatëse si dhe në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>26 - Rregullore e NJSBC 27 - Politikat e cilesise ne UMT</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në aktet rregullatore të brendshme të UMT, në të gjitha nivelet, ka detyra konkrete të përcaktuara në lidhje me të gjitha palët që janë aktorë dhe faktorë në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Në këto rregullore përshkrimi i detyrave specifike për secilin pozicion pune, garanton edhe ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>01 - STATUTI UMT. 03 - Rregullore e brendshme umt. 26 - Rregullore e NJSBC.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>GVJ vlerëson se procedura që ndiqet për sigurimin e cilësisë së programit të studimit përfshihen: njësia bazë e njësia kryesore me raportin për planin e masave e propozimet; anëtarët e stafit akademik e administrativ si subjekt i vlerësimit dhe studentët, si pjesë vlerësuese.</p> <p>26 - Rregullore e NJSBC.</p>

administrative dhe studentëve të programit të studimit.	28 - Raporti Vjetor 2021-2022. 30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga takimi me GVB, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit.  UMT respekton lirinë akademike dhe integritetin e çdo individi duke shmangur çdo lloj diskriminimi. Ky parim barazie i shprehur si frymë e politikës së ndjekur nga institucioni në gjithë procesin, konfirmohet edhe nga stafi e studentët në takimet me ta			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në praktikën e UMT, për vlerësim real dhe efektiv të programit të studimit, është i nevojshëm edhe mendimi i aktorëve dhe ekspertëve të jashtëm. Gjithashtu mobilitetet Erasmus+ kanë ndihmuar në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, organizohen edhe leksione të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit si dhe angazhohen ekspertë të jashtëm për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave.  53 - Lista e leksioneve të hapura, ëorkshopeve, trajnimeve ... etj			
<b>Konkluzione</b>	<i>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Software Enginnering" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës;</i>  <i>NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. Panairi i Punës, mobilitetet Erasmus+ si dhe leksione të hapura, kanë kontribuar në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Bazuar në të drejtën për informim, UMT bën të ditur politikën, strategjinë dhe veprimtaritë që institucioni organizon në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këto informacione secili student apo staf i UMT mund t'i aksesojë në faqen zyrtare web të UMT, ku gjen legjislacionin bazë si Statutin, Kodin e Etikës, Rregulloret e UMT, fakulteteve, Departamenteve, programeve të studimit, raporte, vendime të Bordit të Administrimit etj. Guida e studentit i jepet çdo studenti në fillim të studimeve, orienton më së miri veprimtarinë e studentëve në planin personal.</p> <p><i>26 - Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>28 - Raporti Vjetor 2021-2022.</i></p> <p><i>30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>GVJ vlerëson se NJSBC e UMT publikon raportet e vlerësimit të programit të studimit duke i shpërndarë ato në Njësitë kryesore e Njësitë bazë përkatëse. Këto raporte hartohen duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, ruajtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin. Ky është një proces që monitorohet në vazhdimësi, përmes orientimeve e sugjerimeve që i jepet stafit akademik dhe marrjes së mendimeve prej studentëve. Edhe pyetësi rishikohet e riformulohet here pas here në përshtatje me situatat e reja të krijuara apo problematikave të evidentuara.</p> <p><i>30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Pas diskutimit të rezultateve të pyetësorëve të studentëve në departament, ky i fundit harton një raport me propozime për planin e masave që adreson problematikave që ka evidentuar pyetësi dhe e dërgon në rektorat dhe për miratim në Senatin Akademik. Qëllimi kryesor në këtë proces është njohja e stafit akademik me pritshmëritë që studentët kanë në lidhje me punën e tyre, plotësimi i mangësive të evidentuara në drejtim të</p>



	<p>mësimdhënies apo infrastrukturës dhe minimizimi i dobësive të evidentuara për vitet në vazhdim.</p> <p><i>30 - Rezultatet e vlerësimit të procesit të mësimdhënies</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se rezultatet e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe plani i masave i propozuar dhe miratuar, pasqyrohet në planet e punës së departamenteve. Procesi është periodik dhe bëhet 2 herë brenda 1 viti akademik në FSHKIT dhe NJSBC ka hartuar një raport të detajuar me tabela e grafikë për vizualizimin e rezultateve në nivel fakulteti dhe nivel institucioni. Ky raport jep informacion edhe për përmbajtjen dhe strukturën e pyetësorit. Në këtë proces nxitet pjesëmarrja e gjithë studentëve dhe iu garantohet atyre anonimiteti në anketim. Anketimi aksesohet lehtë prej studentëve përmes platformës “edu4school” dhe rezultatet analizohen nga NJSBC.</p> <p><i>28 - Raporti Vjetor 2021-2022.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e UMT organizohen takime të stafit akademik e studentëve, ku NJSBC informojnë dhe ndërgjegjësojnë stafin akademik në lidhje me rolin që kanë në rritjen e cilësisë së programit të studimit në terma afatgjatë.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të elementëve që kanë të bëjnë me këtë proces. Anëtarët e personelit akademik informohen individualisht në lidhje me rezultatet respektive të përftuara nga pyetësorët e studentëve të cilat lidhen drejtëpërdrejt me performancën e tyre. Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Software Engineering" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. UMT ka ndërtuar struktura institucionale me përkushtim të lartë në drejtim të promovimit të programeve të studimit. Gjithashtu ka ngritur infrastrukturë bashkëkohore (aula, klasa, laboratorë) që krijojnë kushte komode në ndjekjen e programit të studimit.
2. UMT ka realizuar marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit duke krijuar mundësi të mira mobiliteti për stafin akademik dhe studentët.
3. Në Republikën e Shqipërisë ka pak universitete me programit të studimit Master i Shkencave në "Software Engineering" si rrjedhim UMT mund të përfitojë në tërheqjen e studentëve relativisht më të mirë me interes në këtë fushë.

**Pika të dobta**

1. GVJ vlerëson se për këtë program studimi të ri, është e nevojshme lidhja e marrëveshjeve edhe me kompani të tjera kryesisht të fushës së zhvillimit software dhe aplikacioneve në mënyrë që studentët të kalojnë më shpejt në tregun e punës.(Standardi I.3, Kriteri 3)
2. GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit por mbështetja financiare për kërkimin shkencor mbetet relativisht e vogël nga institucioni dhe të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme. Balancat financiare mbahen në nivel institucioni por jo në nivelin e njësisë bazë kjo vështirëson vlerësimin e fondit të kërkimit shkencor.(Standardi II.6, Kriteri 4)
3. Biblioteka ka numër të pa mjaftueshëm të titujve me karakter profesional për studentët e programit në "Software Engineering". Literatura fizike e vlefshme për studentët e programit është relativisht e ulët me gjithë përpjekjet që Universiteti "Metropolitan Tirana" bën për mirëmbajtjen e tyre.(Standardi IV.3, Kriteri 4)

**Rekomandime**

1. GVJ rekomandon që të realizohen më tepër trajnime profesionale me kompanitë me të cilat institucioni ka bashkëpunim, për të ndihmuar studentët drejt kalimit në tregun e punës.
2. GVJ vlerëson se UMT duhet të shtojë përpjekjet për shtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadrin e bashkëpunimit evropian në vitet në vijim
3. GVJ rekomandon angazhimin e të gjithë stafit akademik në aktivitete, workshope e leksione të hapura.
4. GVJ rekomandon nxitjen e motivimin e studentëve të përfitojnë nga financimi i institucionit në mbështetje të zhvillimit të ideve dhe projekteve të tyre

5. UMT t'i kushtojë vëmendje shtimit të literaturës me botime të reja me qëllim që studentët e programit të studimit të "Software Engineering të marrin dije sa më të përditësuara
6. UMT duhet të shtojë më tej përpjekjet për rritjen e të ardhurave nëpërmjet granteve të projekteve kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare si dhe prej shërbimeve trajnuese
7. GVJ rekomandon dokumentimin e procesit të kontrollit për saktësinë e hedhjes së informacionit dhe menaxhimin e tij nga njësitë përgjegjëse duke përfshirë këtu sekretaritet mësimore, sistemin e brendshëm të informacionit etj.
8. GVJ rekomandon gjithsesi që në raportin analitik vjetor të njësisë bazë të përfshihet informacion në lidhje me cilësinë akademike të studentëve dhe shkallën e punësimit në të ardhmen edhe pse kjo nuk është detyrë e drejtpërdrejtë e njësisë bazë
9. GVJ rekomandon nevojën për krijimin e një database me të dhënat e ecurisë profesionale të të diplomuarve.

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Software Engineering" provided by the Higher Education Institution "UMT"**

**Strengths and affirmations**

1. UMT has developed institutional structures with great dedication to support academic initiatives. It has also established contemporary infrastructure (classrooms, labs, offices) that provide suitable surroundings for implementing the study schedule.
2. UMT has signed agreements with universities both inside and outside of Albania therefore providing academic staff and students with excellent mobility possibilities.
3. There are few universities in the Republic of Albania offering a Master of Science degree in "Software Engineering," hence UMT can help in drawing rather excellent students in this sector.

**Weaknesses**

1. GVJ assesses that for this new study program, it is necessary to conclude agreements with other companies mainly in the field of software development and applications so that students can move to the market more quickly. **(Standard I.3, Criterion 3)**
2. GVJ finds that until now the institution has continuously provided financial support for the progress of the study program, but the financial support for scientific research remains relatively small from the institution and the income from various activities. Financial balances are kept at the institution level but not at the basic unit level, this makes it difficult to evaluate the scientific research fund. **(Standard II.6, Criterion 4)**

3. The library has an insufficient number of professional titles for the students of the "Software Engineering" program. The physical literature valuable for the students of the program is relatively low despite all the efforts that "Metropolitan Tirana" University makes for their maintenance. (Standard IV.3, Criterion 4)

### Recommendation

1. GVJ recommends that more professional trainings be carried out with the companies with which the institution has cooperation, to help students towards the transition to the market.
2. GVJ assesses that UMT should increase its efforts to add international agreements in the framework of European cooperation in the following years
3. GVJ recommends the engagement of all academic staff in activities, workshops and open lectures.
4. GVJ recommends encouraging and motivating students to benefit from the institution's funding in support of the development of their ideas and projects
5. UMT should pay attention to the addition of literature with new publications for the students of the "Software Engineering" study program to receive the most up-to-date knowledge
6. UMT should further increase efforts to increase income through grants for national and international scientific research projects as well as training services
7. GVJ recommends the documentation of the control process for the accuracy of the information release and its management by the responsible units, including the teaching secretaries, the internal information system, etc.
8. GVJ recommends anyway that in the annual analytical report of the basic unit include information about the academic quality of students and the rate of future employment even though this is not a direct task of the basic unit
9. GVJ recommends the need to create a database with data on the professional progress of graduates.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>